NR. 30, GUSHT 2024 | Viti III

Revistë e përmuajshme (politike-diplomatike)

# ARGUMENTUM

news opinion analysis



EKSKLUZIVE

## Ambasadori Z. Volodymyr Shkurov: "Asgjë për Ukrainën pa Ukrainën"- Kërkojmë një Paqe të Drejtë dhe të Garantuar!

- "Jehona e irredentizmit dhe minoriteti bullgar në Ballkan"
- "Dashuria e kushtëzuar" e Erdogan. Çfarë kërkon Presidenti turk nga Shqipëria?
- Kryeministri Rama: Mikpresim Samitin e NATO-s në 2027.

ARGUMENTUM
news opinion analysis

## Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

**Argumentum.al** tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.
Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.
**Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpuntorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.
Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

**"Argumentum", një proces intelektual ...**

**Marjana DODA**
**Kryeredaktore**

# Përmbajtja


**03 EDITORIAL**
- "Dashuria e kushtëzuar" e Erdogan. Çfarë kërkon Presidenti turk nga Shqipëria?

**07 INTERVISTA**
- **Ekskluzive**/ Ambasadori ukrainas në Shqipëri, z.Volodymyr Shkurov: "Asgjë për Ukrainën pa Ukrainën"- Kërkojmë një Paqe të Drejtë dhe të Garantuar!

**13 OP/ED**
- "Jehona e irredentizmit dhe minoriteti bullgar në Ballkan"

**17 FOKUS**
- Ofensiva e Ukrainës në Kursk është një pikë kthese në luftë

**19 POLITIKË**
- "Shqipëria në qendër të vëmendjes"/ Kryeministri Rama: Mikpresim Samitin e NATO-s në 2027. Samitin e komunitetit politik në 2025. Perspektiva për BE në 2030.

**20 RAJONI**
- Drejtori i CIA-s takon lidershipin e Kosovës.
- Maqedoni e Veriut/ Shënohet 23-vjetori i Marrëveshjes së Ohrit

**23 BOTA**
- "Përshkallëzimi në Lindjen e Mesme: Si po e përfshin Izraeli Libanin në Luftë dhe Roli Strategjik i SHBA-së"

*ENGLISH EDITION*

**28 ENGLISH TOP NEWS**
- Minister Igli Hasani's Conversation with Journalists Following "Diplo 2024"

**28 BALKAN OVERVIEW**
- The Council of Albanian Ambassadors supports the protest and the legitimate demands of Albanians in the Presheva Valley.
- Officials of United States and the EU voice further support for lithium mining in Serbia

**30 INFOCUS**
- ZUNSETTLED TIMES

**31 GLOBAL**
- Ukrainian ambassador appeals for German support in budget

# "Dashuria e kushtëzuar" e Erdogan.
## Çfarë kërkon Presidenti turk nga Shqipëria?

Marrëdhëniet Shqipëri-Turqi janë të ndërthurura nga një ndjenjë e përzier historike-diplomatike, që herë pas here shoqërohen me nota skepticizmi sapo afrohemi me njëra-tjetrën.
Shqipëria ka qenë për 500 vjet nën sundimin Osman, deri në vitin 1912 kur u shpall dhe Pavarësia nga Perandoria Osmane. Një fakt historik që për hirë të së vërtetës, Turqia zyrtare e shmang.
Megjithatë, shqiptarët nuk mund ta harrojnë historinë e tyre dhe ajo nuk mund të rishkruhet e as të retushohet pavarësisht interesave strategjike gjeopolitike të kohës së sotshme.
Gjithsesi, ky nuk është rasti për të folur për të kaluarën tonë historike ndërmjet dy vendeve tona, por le të flasim për marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Turqisë së sotshme, në periudhen e tyre të dytë historike e cila tashmë i ka shënuar plot 100 vjet dhe që përfshin marrëdhëniet Turqi-Shqipëri pas vitit 1923, pra pas themelimit të Republikës së Turqisë nën udhëheqjen e Mustafa Kemal Ataturk.
Në shekullin e parë të këtyre ma- rrëdhënieve diplomatike, partneriteti mes dy vendeve ka kaluar në partneritet strategjik dhe vëllazëror.
Duke qenë se marrëdhëniet Shqipëri-Turqi e marrin fuqinë e tyre nga historia e përbashkët dhe lidhjet e forta sociale dhe kulturore, bazuar në këtë sfond të rrënjosur thellë, marrëdhëniet dypalëshe u ngritën në Partneritet Strategjik. Ky



partneritet u formalizua me nënshkrimin e Deklaratës së Përbashkët Politike për Krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit të Nivelit të Lartë nga Presidenti Z. Recep Tayyip Erdoğan dhe Kryeministri Z. Edi Rama, më 6 janar 2021, në Ankara.

Përpos marrëveshjeve zyrtare bilateriale, dhe bashkërendimit në arenën ndërkombëtare, janë marrëdhëniet njerëzore që e përforcojnë këtë partneritet. Duhet thënë se nga populli shqiptar nuk harrohet kontributi dhe ndihma e Republikës së Turqisë në tërmetin e datës 26 nëntor 2019 që goditi qarkun e Durrësit dhe Tiranës. Një mirënjohje e përjetshme!

Por ka një boshllëk që ende nuk është mbushur dhe që i trazon marrëdhëniet mes Tiranës dhe Ankarasë zyrtare.

Tentativa për grusht shteti në Turqi në vitin 2016, vendos në sprovë këto marrëdhënie. Qeveria e Turqisë akuzoi Fethullah Gülen dhe ndjekësit e tij si përgjegjës për planifikimin dhe organizimin e grushtit të shtetit, duke e quajtur këtë grup "Organizata Terroriste Fethullahiste" (FETÖ), dhe ndërmori masa të ashpra për të ndëshkuar ata që ishin të përfshirë në grushtin e shtetit, jo vetëm brenda Turqisë, por dhe jashtë saj, sidmos në rajonin tonë.

Që atëherë, sa herë flitet për përforcim të marrëdhënieve Shqipëri-Turqi, menjëherë shoqërohet me një kërkesë nga Erdogan. Kërkesa për veprime të caktuar ose angazhime nga ana e Shqipërisë, duke bërë që kjo dashuri vëllazërore që ai proklamon të vije e kushtëzuar për "vëllezërit shqiptarë".

Kështu u lexua në fakt dhe biseda më e fundit telefonike ndërmjet Presidentit Erdogan dhe Kryeministrit Rama.

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan zhvilloi me date 8 gusht një bisedë telefonike me kryeministrin Edi Rama. Lajm që u bë me dije vetëm nga Drejtoria e Komunikimit të Turqisë, ndërsa nga Zyra e Kryeministrit të Shqipërisë nuk ka pati asnjë reagim.

Presidenti turk ka vlerësuar marrëdhëniet Turqi-Shqipëri raporton media turke "Anadolu Agency", ato janë në një nivel të avancuar. Erdogan i ka thënë Ramës se edhe bashkëpunimi në industrinë e mbrojtjes do të forcohet më tej përmes kontakteve tregtare, ekonomike dhe ushtarake.

> *Në këtë telefonatë Presidenti turk iu referua "përpjekjeve frustruese të organizatës terroriste FETO për të fituar terren në Shqipëri", si dhe shprehu besimin se Tirana do të vazhdojë të punojë drejt eliminimit të strukturës së grupit në sektorët arsimor, shëndetësor dhe fetar, thuhej ndër të tjera. Një kërkesë jo e panjohur për Tiranën zyrtare, e cila sikundër e theksuam më sipër, qëndron si "çekan" mbi qeverinë shqiptare në çdo vizitë zyrtare që zhvillohen mes dy vendeve, apo në çdo angazhim tjetër diplomatik.*

Ai është ndalur dhe të një nga kërkesat e hershme ndaj Shqipërisë, duke insistuar që vendi ynë të mbyllë institucionet arsimore, spitalet dhe institucionet fetare që kanë lidhje me Fondacionin Gylen, i drejtuar nga kundërshtari i tij në ekzil Fethullah Gülen.

Në këtë telefonatë Presidenti turk iu referua "përpjekjeve frustruese të organizatës terroriste FETO për të fituar terren në Shqipëri", si dhe shprehu besimin se Tirana do të vazhdojë të punojë drejt eliminimit të strukturës së grupit në sektorët arsimor, shëndetësor dhe fetar, thuhej ndër të tjera.

Një kërkesë jo e panjohur për Tiranën zyrtare, e cila sikundër e theksuam më sipër, qëndron si "çekan" mbi qeverinë shqiptare në çdo vizitë zyrtare që zhvillohen mes dy vendeve, apo në çdo angazhim tjetër diplomatik.

Edhe Ambasadori i Turqisë në Tiranë, vijon ta konfirmojë këtë kërkesë:

"Partneriteti strategjik do të vazhdojë, siç ju e thatë me të drejtë, Shqipëria ka blerë nga Turqia, dronët BAYRAKTAR, këto marrëdhënie do të vazhdojnë". Kështu i është përgjigjur ambasadori i Turqisë nga Korça, pyetjes se Euronews Albania mbi telefonatën e Ramës me Erdogan.

I pyetur lidhur me organizatën FETO të shpallur si terroriste nga Turqia, ambasadori Tayyar Kağan Atay u shpreh se FETO nuk është rrezik vetëm për Turqinë por edhe për Shqipërinë ndaj pastrimi i tyre nga institucionet arsimore dhe fetare duhet të jetë vendimtar.

*"Lidhur me organizatën FETO duhet te pyesni kryeministrin Edi Rama se si është përgjigjur në telefonatë por mund të them se pjesa e pastrimit të FETO-s nga Shqipëria nuk është vetëm çështje e Turqisë, është edhe çështje e shtetit shqiptar, ata janë të rrezikshëm. Ky pastrim nuk duhet të bëhet vetëm për Turqinë por edhe për një të ardhme më të sigurt të vendit tuaj. Do të marrim përfundimet për këtë temë, ka zhvillime. Dua të theksoj se FETO nuk do jetë pengesë për vazhdimin e partneritetit miqësor të të dyja vendeve. Nuk do lejojmë që të helmojnë miqësinë midis dy shteteve. Kjo është punë që ne do t'i shkojmë deri ne fund"*, u shpreh ambasadori turk në Tiranë, Tayyar Kağan Atay.

E pra, siç e pamë dhe në zbardhjen e kësaj telefonate, vijon të përsëritet kërkesa dhe ultimatumi ndaj Shqipërisë për Gulenistet.

Prej disa vitesh, në çdo vizite zyrtare nga pala shqiptare në Turqi apo nga pala turke në Shqipëri, Presidenti Erdogan ka kërkuar me këmbëngulje që kryeministri Rama të pengojë çdo funksion të organizatës FETO nga KMSH, arsimi drejtësia, policia e shëndetësia. Ndërsa nga njëra anë të zgjasin dorën për partneritet, në anën tjetër e kushtëzojnë atë me kërkesa që bien ndesh me direktivat ndërkombëtare.

Megjithëse Shqipëria ka tentuar të mbaje një qëndrim të balancuar dhe ka bërë përpjekje për të menaxhuar kërkesat e mësipërme, në disa ka dështuar përballë presionit turk duke bërë shkelje flagrante.

***Porositë që ka kryer deri tani qeveria shqiptare sipas kërkesave të Turqisë:***

Shqipëria urdhëroi dëbimin për herë të parë të një anëtari të lëvizjes Gulen në Turqi, mbrëmjen e 1 janarit 2020, duke ngritur shqetësime për dhunim të të drejtave themelore të njeriut. Pas publikimit në rrjetet sociale për dëbimin e Harun Çelik, një orë më vonë, Policia e Shtetit e konfirmoi se po "ka dëbuar" Harun Çelik, 42 vjeç, me profesion mësues.

Në shtator 2020, qeveria mbylli edhe disa institucione të tjera arsimore fetare dhe laike të ngritura me financime turke.

Mbyllja brenda një dite e medreseve "Hafiz Abdullah Zëmblaku" në Korçë dhe "Ali Korça" në Kavajë, si dhe institucionit parauniversitar "Memorial International School of Tirana", që administrohej nga Shoqëria "Turgut Ozal Education" nuk pati një arsyetim publik, por agjencia turke e lajmeve "Anadolu Agency" i quante të lidhura me "strukturat e organizatës terroriste FETO".

> ***Në të njëjtën ditë me vendimin e qeverisë për mbylljen e kolegjit "Mehmet Akif" në Tiranë që ështё i themeluar nga Lëvizja Gulen dhe pak ditë pas mbylljes së një kopshti privat për fëmijë, "Zubeyde Hanim" që është pjesë e shoqërisë "Turgut Ozal Education", Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama tha se gjatë takimit të fundit me Presidentit turk, Rexhep Taip Erdogan, ka folur për marrëveshjen e furnizimit me dron "Bayraktar".Kështu gjatë një interviste për "Opinion" në atë kohe, Rama konfirmoi se Shqipëria do të marrë 6 dron nga Turqia, të cilët do të përdoren për shërbime civile.***

Në vitin 2022, Këshilli i Ministrave vendosi mbylljen e institucionit arsimor parauniversitar "Mehmet Akif Ersoy", i cili funksiononte si kolegj për vajza dhe djem dhe financohej nga fondacioni "Gulistan" i lakuar për lidhjet me klerikun turk Fetullah Gylen, i cili operonte në Tiranë që 26 vjet dhe që është pjesë e Fondacionit Gülistan.

Në të njëjtën ditë me vendimin e qeverisë për mbylljen e kolegjit "Mehmet Akif" në Tiranë që ështё i themeluar nga Lëvizja Gulen dhe pak ditë pas mbylljes së një kopshti privat për fëmijë, "Zubeyde Hanim" që është pjesë e shoqërisë "Turgut Ozal Education", Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama tha se gjatë takimit të fundit me Presidentit turk, Rexhep Taip Erdogan, ka folur për marrëveshjen e furnizimit me dron "Bayraktar".

Kështu gjatë një interviste për "Opinion" në atë kohe, Rama konfirmoi se Shqipëria do të marrë 6 dron nga Turqia, të cilët do të përdoren për shërbime civile.

Nuk dihet nëse vendimi për të mbyllur këto institucione arsimore i ka hapi rrugë blerjes së droneve Bayraktar nga Turqia, por gjithsesi në kronologjinë veprimeve të njëpasnjëshme

na bën të dyshojmë se këto marrëdhënie dhe ky partneritet Shqipëri-Turqi është i kushtëzuar.
Edhe Xhamia e madhe e Namazgjasë raportohet nga qarqe të caktuara në Shqipëri dhe Turqi, se mbahet peng nga presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan. Në fakt, ajo do inaugurohej në fund të Ramazanit të vitit 2022, por akoma besimtarët vazhdojnë të mos falen aty.
"Uroj dhe dëshiroj që shumë shpejt, mbase deri në muajin e Ramazanit, ta kemi zgjidhur dhe problemin e xhamisë së Namazgjasë", deklaroi Erdogan në janar të vitit 2022 në Tiranë.
Ai shmangu nga vizita në janar të 2022 çdo kontakt me Komunitetin Mysliman Shqiptar, kreu i së cilit Bujar Spahiu, që për të është një pinjoll i Fetullah Gylenit. Tensionet mes KMSH dhe Erdogan, si dhe mos përmbushjes së pretimit nga ana e kryeministrit për të shfarosur "gylenistët", duket se ishin arsyet kryesore pse është shtyrë edhe inaugurimi i Xhamisë së Namazgjasë.
Ende sot, kjo Xhami nuk i ka hapur dyert për besimtarët e saj!
Sa më sipër, të gjitha këto lëvizje, kërkesa dhe ultimatume minojnë marrëdhëniet mes dy vendeve.
Së pari, Lidhur me kërkesën e padrejtë që drejton në çdo rast Turqia, ajo shkel Konventen Europiane të Ekstradimit ku sigurisht Shqipëria e ka firmosur. Konkretisht nenin 19, pika 2 të Kartës Europiane për të Drejtat Themelore, ku shprehimisht shkruhet: "Askush nuk mund të hiqet, dëbohet ose ekstradohet drejt një Shteti ku ka rrezik serioz që ai apo ajo t'i nënshtrohet dënimit me vdekje, torturës apo trajtimeve të tjera ç'njerëzore apo degraduese".



> Edhe Xhamia e madhe e Namazgjasë raportohet nga qarqe të caktuara në Shqipëri dhe Turqi, se mbahet peng nga presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan. Në fakt, ajo do inaugurohej në fund të Ramazanit të vitit 2022, por akoma besimtarët vazhdojnë të mos falen aty.

Së dyti, Shqiperia nuk e cilëson si organizatë terroriste, Fetullah Gulen, dhe nuk ka asnjë tagër që të largojë, dëbojë asnjë përkrahës, apo ndjekës të tij. Aq më tepër nga institucionet ligjzbatuese të vendit tonë nuk është sinjalizuar që kjo organizatë apo individë të lidhur me të përbëjnë kërcënim për Shqipërinë.
Se treti, Presioni Politik dhe Mediatik. Prej 8 vitesh çështjet e lëvizjes së Gülenit dhe kërkesat për ekstradim janë bërë pjesë e diskutimeve dhe presioneve mediatike dhe politike, duke shenjëstruar si "gylenistë" këdo që ka mendim ndryshe nga Ankaraja zyrtare për Ish-mikun e Erdogan, Fetullah Gulen. Duke ndikuar kësisoj drejtpërdrejtë edhe në perceptimin publik të marrëdhënieve Shqipëri-Turqi.
Padiskutim, Shqipëria dhe Turqia duhet të konsolidojnë dhe thellojnë më tej Partneritetin e tyre Strategjik, si dy vende të lidhura nga historia, si anëtare të NATO-s dhe si partnerë që po forcojnë bashkëpunimin në të gjitha fushat në nivel dypalësh, rajonal apo dhe global.
Megjithatë, çdo kushtëzim ose ultimatum që minon demokracinë dhe shtetin ligjor shqiptar, rrezikon të dëmtojë këtë partneritet jo vetëm strategjik por dhe vëllazëror.

EKSKLUZIVE/ AMBASADORI UKRAINAS NË SHQIPËRI, Z.VOLODYMYR SHKUROV:

# "Asgjë për Ukrainën pa Ukrainën" Kërkojmë një Paqe të Drejtë dhe të Garantuar!

*Intervistë Ekskluzive për ARGUMENTUM.al me Ambasadorin e Ukrainës në Shqipëri, SHTZ. Volodymyr Shkurov*



**Intervistoi: Marjana Doda**



33-vjetori i Pavarësisë së Ukrainës përkoi me ditën e 913-të të kësaj lufte të tmerrshme që Rusia nisi kundër Ukrainës. Natyrisht, askush me mendje të shëndoshë nuk mund ta kishte imagjinuar se diçka e tillë – dua të them kjo luftë – mund të ndodhte. Por lufta vazhdon; njerëz po vdesin, ushtarë dhe civilë, fëmijë; qytete dhe fshatra po shkatërrohen, infrastruktura kritike po asgjësohet", kështu shprehet **Ambasadori i Ukrainës në Shqipëri, SHTZ. Volodymyr Shkurov** në një intervistë ekskluzive për **Argumentum.al**.

Një intervistë e shoqëruar me emocion dhe trishtim ndërsa Ambasadori Shkurov flet për një bilanc në humbje njerëzore, zhvendosje popullate, ku 7 milionë ukrainas janë detyruar të jetojnë jashtë vendit për shkak të kësaj lufte, shkatërrim të infrastrukturës, por mbi të gjitha për krime ndaj njerëzimit që janë të dokumentuara.

E kur bëhet fjalë për dëshmi e dokumentime, Ambasadori Shkurov insiston të shohim një video, të cilën e gjeni në fund të kësaj interviste me dëshmi të rënda që flet për dhunimin e vajzave dhe grave ukrainase pa marrë parasysh as moshën e mitur të tyre.

"Njerëz të pafajshëm janë në rrezik të vdesin, sepse një diktator në një vend fqinj vendosi të pushtonte Ukrainën, duke menduar se kishte të drejtë ta bënte këtë në Shekullin i 21-të, në zemër të Evropës", shprehet Ambasadori Shkurov.

I pyetur në këtë intervistë për solidaritetin dhe ndihmën e Perëndimit, kryesisht atë ushtarake, Ambasadori thekson se kjo ndihmë është e fuqishme, por ende e pamjaftueshme.

*" E kuptoj se pyetja juaj ka të bëjë kryesisht me ndihmën ushtarake për Ukrainën. Kjo ndihmë është e fuqishme, por ende e pamjaftueshme. Behet fjalë për municione me rreze të gjatë veprimi, për mjete të blinduara, avionë luftarakë, dhe të tjera. Për momentin, vendimet e duhura nga partnerët tanë strategjikë ende nuk janë marrë, por presidenti ynë po e këmbëngule për këtë në menyrë të argumentuar. Bombardimet e fundit në Kharkiv, Sumy dhe qytete të tjera afër kufirit rus dëshmojnë për nevojën eks-*

*treme për të ndalur shkatërrimin kriminal të popullatës civile dhe infrastrukturës kritike të Ukrainës përmes përdorimit të armëve me rreze të gjatë për të sulmuar bazat, nga të cilat rusët kryejnë këto sulme terroriste.*"

Lidhur me Tiranën zyrtare, nisur dhe nga Samiti që u mbajt në Tiranë më 28 shkurt 2024 mes Ukrainës dhe vendeve të Evropës Juglindore, Ambasadori vlerësoi ndër të tjera dhe nënshkrimin nga Ukraina dhe Shqipëria të Traktatit Bazë për Miqësinë dhe Bashkëpunimin.

"*Rolin e Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit në mbështetje të Ukrainës e vlerësoj shumë lartë. Ne tashmë përmendëm Samitin e 28 shkurtit, i cili u zhvillua në Tiranë. Gjatë samitit, Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, zhvilloi takime të frytshme dypalëshe me të gjithë përfaqësuesit kryesorë të vendeve të rajonit të Ballkanit që morën pjesë në samit. Sa i përket bashkëpunimit tonë me Shqipërinë, ne aktualisht po punojmë në përgatitjet për samitet (në nivel shtetëror dhe parlamentar) që i kushtohen Platformës së Krimesë, si dhe po përgatisim takime të tjera ndërkombëtare në nivel ministrash sektorialë. Të mos harrojmë edhe për perspektivën e hapjes së Ambasadës së Shqipërisë në Ukrainë, e cila do të forcojë më tej parametrat e bashkëpunimit mes vendeve tona miqësore*", thekson Ambasadori Shkurov.

Për tju rikthyer ndihmës ndërkombëtare.

I pyetur për Samitin e fundit të NATO-s mbajtur në Uashington dhe angazhimit të saj për Ukrainën, Ambasadori përgjigjet:

"*NATO mbetet një nga partnerët më të fuqishëm të Ukrainës në përballimin e agresionit rus. Asistenca ushtarake dhe llojet e tjera të ndihmës së NATO-s për Ukrainën. Ato përfshijnë pajisje teknologjike të avancuara, zgjidhje të shumta logjistike, trajnim për ushtarët tanë, municion, armë dhe shumë gjera të tjera. NATO mbështeti operacionin e Ukrainës në drejtim të Kurskut. Gjithashtu, shefi i NATO-s pas fillimit të këtij operacioni theksoi se Ukraina rrezikon duke ndërmarrë veprime sulmuese në territorin rus, por Kyivi duhet të vendosë vetë se si do të zhvillojë fushatën e tij ushtarake*"

> **"Ne tashmë përmendëm Samitin e 28 shkurtit, i cili u zhvillua në Tiranë. Gjatë samitit, Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, zhvilloi takime të frytshme dypalëshe me të gjithë përfaqësuesit kryesorë të vendeve të rajonit të Ballkanit që morën pjesë në samit. Sa i përket bashkëpunimit tonë me Shqipërinë, ne aktualisht po punojmë në përgatitjet për samitet (në nivel shtetëror dhe parlamentar) që i kushtohen Platformës së Krimesë, si dhe po përgatisim takime të tjera ndërkombëtare në nivel ministrash sektorialë."**

Sa i përket inkursionit nga Ukraina në rajonin e Kurskut të Rusisë, Ambasadori Shkurov në këtë intervistë, thekson se Operacioni i Kurskut ndryshoi parametrat e asaj që Rusia e quan operacion special ushtarak.

"*Në përgjigje të sulmeve ruse ndaj infrastrukturës energjetike të Ukrainës, ky operacion tregoi aftësinë për sulme të suksesshme nga ana e Ukrainës pikërisht në territorin rus. Sot është e vështirë të flitet për të gjitha aspektet e këtij operacioni, por është e qartë për të gjithë se Rusia mund të vazhdoj pa mbarim luftime në territorin e Ukrainës, duke mbajtur kështu në shënjestër edhe vendet fqinje evropiane*".

Po ndërsa lufta në Ukraine ka hyrë në vitin e tretë, ka patur paralelisht propozime dhe tentativë për ndërmjetësim në zgjidhjen e këtij konflikti nga shtete të ndryshme si Kina, si Turqia, Afrika, gjithashtu nga Hungaria, Brazili, etj.

"*Ne vlerësojmë rolin e të gjithë ndërmjetësve ndërkombëtarë, shumica e të cilëve, për hir të së vërtetës, njohin sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit tonë dhe deklarojnë respekt për të drejtën ndërkombëtare dhe Kartën e OKB-së. Megjithatë, Ukraina mbështetet në parimet themelore e formulës së saj të paqes. Është mbajtur Samiti i parë i paqes. Tani po përgatitet Samiti i dytë i paqes, i cili pritet të mbahet deri në fund të këtij viti. Ukraina dhe partnerët e saj ndërkombëtarë ndjekin formulën "asgjë për Ukrainën pa Ukrainën". Ukraina po kërkon një paqe të drejtë dhe të garantuar*", thekson shprehimisht Ambasadori.

"Si diplomat, më vjen keq që dialogu për paqen nuk po zhvillohet në tavolinën e negociatave, por në vijën e frontit", shprehet Ambasadori në intervistën e




mëposhtme.

**INTERVISTA E PLOTË:**

**Znj. Marjana Doda**: I nderuar Ambasador,
Ju falënderoj për intervistën dhe dëshiroj t'Ju uroj Ju dhe popullin ukrainas për 33-vjetorin e Pavarësisë!

**-Ky përvjetor përkon me një moment historik të rëndësishëm, por tragjik–tashmë numërohen 30 muaj të luftës gjithëpërfshirëse që Rusia ka nisur kundër Ukrainës, dhe ky është viti i tretë që Ukraina feston Pavarësinë e saj ndërsa përballon një luftë ekzistenciale. Pra është një kohë e mjaftueshme për të berë një bilanc. Në këtë kontekst, cilat janë mendimet tuaja mbi situatën aktuale dhe pasojat e saj për të dy palët, duke marrë parasysh gjithashtu sfidat dhe pritshmëritë për të ardhmen?**

**SHTZ. Volodymyr Shkurov:** Ju falënderoj për interesimin Tuaj dhe për urimet Tuaja me rastin e 33-vjetorit të pavarësisë së Ukrainës. Këtë vit, Dita e Pavarësisë përkoi me ditën e 913-të të kësaj lufte të tmerrshme që Rusia nisi kundër Ukrainës. Natyrisht, askush me mendje të shëndoshë nuk mund ta kishte imagjinuar se diçka e tillë – dua të them kjo luftë – mund të ndodhte. Por lufta vazhdon; njerëz po vdesin, ushtarë dhe civilë, fëmijë; qytete dhe fshatra po shkatërrohen, infrastruktura kritike po asgjësohet. Më shumë se 7 milionë ukrainas janë detyruar të jetojnë jashtë vendit për shkak të kësaj lufte, gjë që, siç e kuptoni, ndikon ndjeshëm në situatën demografike në terresi në Ukrainë. Është e vështirë të vlerësosh situatën aktuale, sepse është praktikisht e pamundur të distancohesh nga perceptimi emocional i asaj që po ndodh. E them këtë, duke pasur parasysh para së gjithash numrin e madh të njerëzve që për fat të keq kanë humbur jetën dhe krimet e shumta kundër njerëzimit që janë dokumentuar. Unë do të doja t'i sugjeroja audiencës suaj një video të shkurtër, që biseda jonë (sidomos kur flasim për elementin ekzistencial të kësaj lufte) të jetë më konkrete dhe që ne të kuptojmë sadopak atë që po ndodh me njerëzit në Ukrainë. [*Videon-e gjeni në fund të kësaj interviste*]
Problemi kryesor, sipas mendimit tim, është se kjo luftë e gjatë po vazhdon dhe po përshkallëzohet, dhe njerëz të tjerë të pafajshëm janë në rrezik të vdesin, sepse një diktator në një vend fqinj vendosi të pushtonte Ukrainën, duke menduar se kishte të drejtë ta bënte këtë. Shekulli i 21-të. Në zemër të Evropës.

**–Duke marrë parasysh se lufta në lindje të Evropës ka hyrë në vitin e saj të tretë dhe ka pasur sfida të mëdha si mungesa e municioneve dhe dyshimet mbi ndihmën perëndimore, si mund të ndikojnë këto faktorë në të ardhmen e Ukrainës dhe çfarë masash mund të merren për të përmirësuar situatën e saj? Sa ndihmë më shumë mund të presë Ukraina nga Shtetet e Bashkuara dhe Perëndimi?**

-Solidariteti me Ukrainën është shprehur pothuajse nga e gjithë bota. Ukraina merr një ndihmë të madhe nga SHBA dhe partnerët tanë evropianë. Akset e rëndësishme të ndihmës përfshijnë përdorimin e aseteve të ngri-

ra ruse, mbështetjen e stabilitetit ekonomik, mbrojtjen dhe energjinë, përditësimin sistematik të tregut të punës në Ukrainë, mënyrat për të rritur të prurjet në buxhetin e shtetit dhe për të tejkaluar deficitin buxhetor, dhe nevojat financiare për vitin 2025. Një aspekt i rëndësishëm i negociatave aktuale me SHBA është për mundësinë e zgjerimit të eksportit të çelikut ukrainas në tregun amerikan, veçanërisht duke shtyrë për një vit tjetër pezullimin e tarifës shtesë prej 25% për importin e çelikut ukrainas. Po ashtu vazhdojnë diskutime për përforcime reale të mbrojtjes sonë ajrore (PVO), që na nevojitet jashtë mase. Përveç kësaj, diskutohet gjithashtu me SHBA dhe partnerët për nevojat urgjente të mbrojtësve tanë, trajnimin e ushtarëve ukrainas dhe prodhimin e përbashkët të armëve. Së fundmi, Sekretari i Shtetit i SHBA-së, Antony Blinken, njoftoi një paketë të re ndihme prej 2 miliardë dollarësh. Ukraina është e interesuar të përdorë këto fonde për prodhimin e armëve në Ukrainë së bashku me kompanitë amerikane, veçanërisht përmes krijimit të ndërmarrjeve të përbashkëta mbrojtëse. E kuptoj se pyetja juaj ka të bëjë kryesisht me ndihmën ushtarake për Ukrainën. Kjo ndihmë është e fuqishme, por ende e pamjaftueshme. Bëhet fjalë për municione me rreze të gjatë veprimi, për mjete të blinduara, avionë luftarakë, dhe të tjera. Dua të theksoj se kompleksi ushtarak-industrial i Ukrainës është tani duke punuar fuqishëm dhe efektivisht. Ne prodhojmë lloje të rëndësishme të armatimeve, mjete speciale transporti, dronë dhe të tjera. Sigurisht, mbetet e ndjeshme nevoja për armë me rreze të gjatë dhe për aftësinë reale për të shkatërruar bazat ushtarake dhe mjete armike, nga ku bëhen sulme ndaj qyteteve civile të Ukrainës. Për momentin, vendimet e duhura nga partnerët tanë strategjikë ende nuk janë marrë, por presidenti ynë po e këmbëngule për këtë në menyrë të argumentuar. Bombardimet e fundit në Kharkiv, Sumy dhe qytete të tjera afër kufirit rus dëshmojnë për nevojën ekstreme për të ndalur shkatërrimin kriminal të popullatës civile dhe infrastrukturës kritike të Ukrainës përmes përdorimit të armëve me rreze të gjatë për të sulmuar bazat, nga të cilat rusët kryejnë këto sulme terroriste.

**–Pas 30 muajsh luftë në Ukrainë, a kanë pasur ndikim të dukshëm sanksionet perendimore kundër Rusisë dhe si kanë ndikuar ndarjet gjeopolitike dhe politikës ndërkombëtare në eficiencën e tyre?**

-Po, sanksionet ndërkombëtare kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë një ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Rusisë. Duke përmendur mosmarrëveshjet gjeopolitike, ju me siguri keni parasysh ndihmën që Rusia ka marrë nga vende si Irani dhe Koreja e Veriut. Sigurisht, deri më tani, gjendeshin elemente që zvogëlojnë efektin e këtyre sanksioneve ndërkombëtare, por ato nuk kanë një ndikim të madh në efektivitetin e vetë të sistemit e sanksioneve, lista dhe specifikat e të cilave vazhdojnë të përmirësohen. Procesi i stagnacionit të ekonomisë ruse është nisur pikërisht për shkak të veprimeve të sanksioneve. Shpresoj se sanksionet e reja do të thellojnë shkatërrimin e ekonomisë ruse.

**–Gjatë Samitit mes Ukrainës dhe vendeve të Evropës Juglindore, që u mbajt më 28 shkurt, në Tiranë, Presidenti Zelensky kërkoi bashkëprodhimin e municioneve në fabrikat e vendosura në Ballkan. Si do të ndikojë kjo kërkesë në përpjekjet e Ukrainës për të përballuar mungesën e municioneve dhe për të arritur një fitore në luftë, dhe çfarë roli mund të luajnë vendet e Ballkanit në këtë proces?**

-Samiti që u mbajt në Tiranë më 28 shkurt ishte shumë i suksesshëm. Para së gjithash, në aspektin e konfirmimit të mbështetjes së qartë për Ukrainën nga të gjitha vendet e Evropës Juglindore, gjë që u pasqyrua, veçanërisht, në miratimin e Deklaratës përkatëse nga vendet pjesëmarrëse në samit. Dëshiroj të theksoj veçanërisht, formatin dypalësh të eventit të përmendur, përkatësisht mbajtjen e negociatave konstruktive dypalëshe dhe nënshkrimin nga Ukraina dhe Shqipëria të Traktatit Bazë për Miqësinë dhe Bashkëpunimin. Lidhur me tematikën e mbrojtjes, edhe ajo u diskutua në detaje. Janë arritur dakordësime përkatëse, të cilat aktualisht janë duke u përpunuar në nivel ekspertësh. Të mos harrojmë se, për shembull, Shqipëria është gjithashtu e interesuar për reformimin dhe restaurimin e kompleksit të saj ushtarak-industrial ende relativisht të fuqishëm pak kohë më parë si dhe aktiviteteve të ndërmarrjeve përkatëse të mbrojtjes.

**-Në Kuçovë të Shqipërisë më 4 mars u përurua baza ajrore taktike e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), e para bazë e aleancës në rajonin e Ballkanit Perëndimor, a do të luaje rol kjo baze për Ukrainën**



**dhe si mund ta ndihmojë atë?**

-Baza ajrore taktike e NATO-s, e cila u inagurua më 4 mars në Kuçovë (me që ra fjala, edhe unë isha atje në ceremoninë e hapjes), para së gjithash ka rëndësi për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Bëhet fjalë për një element i rëndësishëm i balancës së forcave në një rajon strategjikisht të rëndësishëm të Ballkanit në përgjithësi. Për sa i përket rëndësisë së kësaj baze për Ukrainën, ende nuk mund të flasim për këtë. Të paktën tani për tani. Ndoshta në të ardhmen kjo do të bëhet e aktualitetit.

**–Lufta mes Izraelit dhe palestinezëve në Gaza, e cila për disa muaj e eklispoi Ukrainën nga vëmendja perëndimore, tregoi se sa e brishtë mbetet rezistenca ukrainase nga zhvillimet në rajone të tjera dhe se sa të kufizuara janë mundësitë e Perëndimit (veçanërisht të ShBA-së) për të luftuar njëkohësisht në shumë fronte. Cfarë duhet bërë më shumë nga Perendimi në ndihme të Ukrainës ?**

-Lufta e Izraelit me grupin terrorist Hamas u bë një problem i madh jo vetëm për rajonin, por edhe për të gjithë botën. Ne e dimë për numrin e madh të viktimave civile si në Izrael ashtu edhe në Rripin e Gazës, dimë për përpjekjet ndërkombëtare për të trajtuar problemet humanitare dhe për përpjekjet ndërkombëtare për të ndaluar këtë luftë. Kam patur përvojë pune në rajonin në fjalë dhe e përjetoj këtë tragjedi me shumë dhimbje, përsëri, nga një këndvështrim njerëzor. Megjithatë, dua të theksoj se Shtetet e Bashkuara dhe partnerët tanë perëndimorë, edhe në këtë situatë të ndërlikuar në Lindjen e Mesme, vazhdojnë të ndihmojnë Ukrainën, duke zbatuar marrëveshjet përkatëse.

**–Si e vlerësoni rolin e Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit në krijimin e një koalicioni më të gjerë për mbështetje dhe ndihmë për Ukrainën, dhe cilat janë hapat e ardhshëm që do të ndërmerrni për të forcuar këtë bashkëpunim?**

-Rolin e Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit në mbështetje të Ukrainës e vlerësoj shumë lartë. Ne tashmë përmendëm Samitin e 28 shkurtit, i cili u zhvillua në Tiranë. Gjatë samitit, Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, zhvilloi takime të frytshme dypalëshe me të gjithë përfaqësuesit kryesorë të vendeve të rajonit të Ballkanit që morën pjesë në samit. Pothuajse të gjitha këto vende të rajonit po përfundojnë procesin e negociatave me Ukrainën për përgatitjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve përkatëse të sigurisë. Proceset të sinkronizuara integruese përsa i përket Bashkimit Evropian, po vazhdon bashkëpunimi në kontekstin e shkëmbimit të përvojës ligjore dhe të tjera. Sa i përket bashkëpunimit tonë me Shqipërinë, ne aktualisht po punojmë në përgatitjet për samitet (në nivel shtetëror dhe parlamentar) që i kushtohen Platformës së Krimesë, si dhe po përgatisim takime të tjera ndërkombëtare në nivel ministrash sektorialë. Të mos harrojmë edhe për perspektivën të hapjes së Ambasadës së Shqipërisë në Ukrainë, e cila do të forcojë më tej parametrat e bashkëpunimit mes vendeve tona miqësore.

**-Deklarata e Samitit të Uashingtonit e lëshuar nga krerët e shteteve dhe qeverive të NATO-s më 10 korrik 2024 përmban disa angazhime kryesore dhe prioritete strategjike. Cilat janë masat konkrete që NATO ka marrë për të forcuar mbrojtjen e Ukrainës pas këtij samiti?**

-NATO mbetet një nga partnerët më të fuqishëm të Ukrainës në përballimin e agresionit rus. Asistenca ushtarake dhe llojet e tjera të ndihmës së NATO-s për Ukrainën, është e vështirë të mbivlerësohet. Ato përfshijnë pajisje teknologjike të avancuara, zgjidhje të shumta logjistike, trajnim për ushtarët tanë, municion, armë dhe shumë gjera të tjera. NATO mbështeti operacionin e Ukrainës në drejtim të Kurskut. Gjithashtu, shefi i NATO-s pas fillimit të këtij operacioni theksoi se Ukraina rrezikon duke ndërmarrë veprime sulmuese në territorin rus, por Kyivi duhet të vendosë vetë se si do të zhvillojë

fushatën e tij ushtarake. "Presidenti Zelenskyy e ka bërë të qartë se operacioni ka për qëllim krijimin e një zone të sigurisë për të parandaluar sulmet e mëtejshme ruse përtej kufirit. Si çdo operacion ushtarak, kjo është e lidhur me rreziqe. Por ky është një vendim që i takon Ukrainës të vendosë se si të mbrohet", theksoi sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.

**-Inkursioni i befasishëm i Ukrainës në rajonin e Kurskut të Rusisë, i dha luftës një kthesë befasuese, lëvizje që mund të ndikojnë në trajektoren e luftës. Por a po e largon mundesinë e paqes sulmi ushtarak i Ukrainës brenda territorit rus? Si ndihmon ky veprim në planin e mbrojtjes dhe ofensivës? A mund të na thoni më shumë rreth mënyrës se si Ukraina planifikon të përdorë këtë momentum për të forcuar pozitat e saj dhe për të arritur qëllimet strategjike?**

-Operacioni i Kurskut ndryshoi parametrat e asaj që rusia e quan operacion special ushtarak. Sulmi në Kursk tregoi mundësinë e zhvendosjes së luftimeve në territorin rus me perspektivën e parandalimit të krijimit nga rusia të ashtuquajturave zona tampon; ky operacion dobësoi ndjeshëm intensitetin e veprimeve ushtarake të rusisë drejt Kharkivit dhe Sumit. Në përgjigje të sulmeve ruse ndaj infrastrukturës energjetike të Ukrainës, ky operacion tregoi aftësinë për sulme të suksesshme nga ana e Ukrainës pikerisht në territorin rus. Sot është e vështirë të flitet për të gjitha aspektet e këtij operacioni, por është e qartë për të gjithë se Rusia mund të vazhdoj pa mbarim luftime në territorin e Ukrainës, duke mbajtur kështu në shënjestër edhe vendet fqinje evropiane.

**–Kemi parë propozime për ndërmjetësim të këtij konflikti nga aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë, si Turqia, Kina, Afrika, gjithashtu nga Hungaria, Brazili, Katari, dhe se fundmi nga India. Cili nga këto propozime i afrohet kërkesave të Ukrianes? Si është vlerësuar roli i këtyre ndërmjetësve në proceset e negociatave dhe arritjen e paqes?**

-Pala ukrainase i kushton vëmendje të madhe të gjitha propozimeve ndërkombëtare për ndërmjetësim për përfundimin e luftës. Ne vlerësojmë rolin e të gjithë ndërmjetësve ndërkombëtarë, shumica e të cilëve, për hir të së vërtetës, njohin sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit tonë dhe deklarojnë respekt për të drejtën ndërkombëtare dhe Kartën e OKB-së. Megjithatë, Ukraina mbështetet në parimet themelore e formulës së saj të paqes. Është mbajtur Samiti i parë i paqes. Tani po përgatitet Samiti i dytë i paqes, i cili pritet të mbahet deri në fund të këtij viti. Ukraina dhe partnerët e saj ndërkombëtarë ndjekin formulën "asgjë për Ukrainën pa Ukrainën". Ukraina po kërkon një paqe të drejtë dhe të garantuar.

**– Kremlini ka deklaruar se i vetmi zhvillim që mund të pranonte për dialog është dorëzimi i Ukrainës dhe kërkesat për "denazifikim" dhe "demilitarizim". A ka ndonjë shpresë për një zgjidhje paqësore duke marrë parasysh këto kushte? Nga ana tjetër, cilat janë termat e propozuar nga Ukraina dhe sa të realizueshme janë ata për të arritur një marrëveshje që të pranohet nga të dy palët?**

-Fatkeqësisht, gjendja aktuale e gjerave në lidhje me vendosjen e paqes mban karakterin ultimativ. Kjo është e keqe nga përkufizimi, pasi kjo qasje objektivisht çon në një rritje të numrit të viktimave. Mendoj se edhe idetë për armëpushim edhe për vendosjen e paqes janë konstruktive sipas natyrës se tyre, por, për fat të keq, tani nuk funksionojnë në kuptimin e tyre të aplikuar. Jo vetëm Ukraina, por edhe e gjithë bota e qytetëruar është bindur se të besosh Putinin do të thotë të mashtrosh veten. Në të njëjtën kohë, asgjë nuk është e pamundur në politikë. Nisur nga kjo, shpresojmë në një rol përkatës të SHBA-së dhe BE-së, si dhe të vendeve të Lindjes globale.

**–Së fundmi, Z. Ambasador-Cilat janë sfidat kryesore në procesin e negociatave për paqe? Dhe më e rendisishmja a ka vullnet për paqe dhe zgjidhjen përfundimtare të këtij konflikti?**

Po, sigurisht. Vullneti për paqe ekziston. Dhe dëshira për paqe është dëshira më e madhe e ukrainasve, të cilët po paguajnë një çmim të tmerrshëm në këtë luftë. Si diplomat, më vjen keq që dialogu për paqen nuk po zhvillohet në tavolinën e negociatave, por në vijën e frontit. Do të doja shumë që kjo luftë të përfundonte sa më shpejt, dhe që njerëzit të mund të ktheheshin në jetën e tyre të zakonshme. Pasi tashmë erdhi dhe shtatori, i cili për të gjithë ne lidhet me fillimin e vitit shkollor. Fëmijët tanë janë të privuar nga mundësitë elementare të një jete në paqe, dhe për të tretin vit radhazi ata po përballen me sfidat e tmerrshme të luftës. Kjo është e tmerrshme…

# "Jehona e irredentizmit dhe minoriteti bullgar në Ballkan"

Nga Marjana DODA




Bulgaria (1878).
Treaty of San Stefano and Congress of Berlin.

Ballkani ka qenë historikisht një rajon me interes dhe konkurrencë të ashpër gjeopolitike. Historia e tij është e mbushur me konflikte etnike dhe fetare, ku luftërat dhe ndarjet kanë krijuar ndasi të thella ndërmjet grupeve etnike.

Politikanët shpesh përdorin çështjet etnike për përfitime politike, duke nxitur përçarje dhe mosbesim për të konsoliduar pushtetin e tyre. Megjithatë, në vitet e fundit, kemi parë se disa vende të rajonit po arrijnë qëllimet e tyre historiko-politike tashmë edhe nën maskën e integrimit europian. Një shembull konkret është Bullgaria, e cila, si anëtare e Bashkimit Evropian, ka përdorur aspirimin ndaj integrimit europian si një mjet për të siguruar interesat e saj ne rajon. Në emrin e mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve dhe përpjekjeve për të ruajtur identitetin etnik po krijohen tensione të reja dhe sfida për integrimin dhe bashkëpunimin rajonal.

Në fakt pakicat minoritare në këndvështrimin tim janë një urë lidhëse mes dy vendeve dhe dy popujve pavarësisht vendeve ku janë, ose të paktën kështu do duhet të ishte, pasi ato kanë gjithë potencialin që si ambasadorë të vërtetë të veprojnë si urë lidhëse midis kombeve, duke nxitur mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkulturor.

Megjithatë, sikundër na ka treguar historia jo shumë e largët në Ballkan, pakicat mund të bëhen burime tensioni dhe konflikti.

Ballkani ka qenë gjithashtu një arenë e fortë për irredentizmin për shkak të përzierjes së grupeve etnike dhe interesave të ndryshme kombëtare. Që nga shekulli i 19-të, disa kombe ballkanike kanë tentuar të zgjerohen në territore ku banojnë popuj të ngjashëm etnikë. Për shembull nacionalistët serbë kanë kërkuar territore për shkak të popullsive të ngjashme etnikisht.

Në disa raste të tjera, politika e jashtme e vendeve ka qenë e lidhur me aspekte historike dhe i shohin këto territore si vende ku mund të shtrijnë influencen e tyre, si për shembull Turqia, e cila, edhe pse ka kaluar një periudhë të gjatë që nga sundimi Otoman në Ballkan, ende e ndien ndikimin e kësaj trashëgimie dhe përpiqet të ruajë influencen e saj në rajon. Po ashtu Greqia, ka aspirata që lidhen me trashëgiminë e Aleksandrit të Madh, edhe pse gjurmët e tij nuk përputhen plotësisht me mitologjinë Helene, por nga ana tjetër nuk plotësojnë as dëshirat e maqedonasve të sotëm.

Gjithsesi të ndalemi te Bullgaria, e cila di të fshehë mirë "orekset" e saj historike.

Prej vitesh ajo po punon fort në promovimin e minoriteteve ne rajon, çka më bën të mendoj se përtej interesit ndaj një pakice minoritare në Ballkan, Bullgaria mund të ketë gjithashtu interesa për të theksuar lidhjet historike dhe për të adresuar çështje të

mëparshme që lidhen me ndryshimet territoriale dhe ndikimet gjeopolitike në rajon.

Këtë intensitet diplomatik në emrin e minoriteti bullgar e kemi parë në Shqipëri e cila ia ka arritur qëllimit të saj, të bëhet minoriteti i tetë.

Duhet thënë se Bullgaria dhe Shqipëria mbajnë marrëdhënie diplomatike që karakterizohen nga bashkëpunimi i ngushtë dhe marrëdhënie miqësore. Megjithatë, shqiptarët nuk e harrojnë se vetoja bullgare ndaj Maqedonisë së Veriut ka ndikuar gjithashtu në bllokimin e përpjekjeve të këtij vendi për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian. (Vetoja e vendosur nga Bullgaria disa vite më parë kishte për qëllim kërkesën për përfshirjen e pakicës bullgare në kushtetutën e Maqedonisë së Veriut, e cila ende përbën pengesën kryesore formale për nisjen e negociatave të anëtarësimit të vendit në BE.")

Pretendimet e Bullgarisë në lidhje me minoritetet në rajon varen nga konteksti historik dhe politik. Po ndërsa historianet, akademikët e shkencave nuk kanë dalë ende me fakte e dokumente që të përcaktojnë qartë çështjen e minoriteteve në vendet tona, politikanët janë ata që këtë boshllëk e mbushin sipas oreksit dhe interesit të tyre politik.

Pretendimet e Bullgarisë në lidhje me minoritetet janë rizgjuar ethshëm sidmos pas anëtarësimit të saj në Bashkimin Europian, ku pakicat e ndryshme që jetojnë përgjatë kufirit në Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Serbi, u joshen nga pasaporta bullgare, që i mundësonte largimin drejt BE-së. Gjithashtu, Bullgaria ka përdorur ndikimin e saj në Bashkimi Evropian për të adresuar çështjet e minoriteteve dhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të tyre në rajon. Kjo është bërë në kuadër të përpjekjeve për zgjerimin e BE-së dhe integrimin e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor.

Por le të mos bëhemi "konspirativ" dhe ta shohim këtë mbështje të Bullgarisë për minoritetet si një shembull pozitiv se si Bullgaria është një vend që respekton dhe mbështet diversitetin kulturor.

Do ta besoja plotësisht një gjë të tillë, nëse vërtet Bullgaria do të njihte dhe do të respektonte minoritetet që janë Bullgari.

Përkundrazi, ajo njeh minoritetin turk, ndoshta për faktin se Turqia ka influencë ekonomike e politike dhe Bullgarisë nuk i leverdis një luftë me Erdogan, por Bullgaria nuk njeh asesi minoritetin maqedonas i cili përbëhet nga mijëra qytetarë maqedonas që jetojnë në pjesën më të madhe ndërkufitare me Maqedoninë e Veriut. Një komunitet i njohur dhe nga gjykatat ndërkombëtare, por jo nga Bullgaria.

Sot autoritetet Bullgare mohojnë çdo ekzistencë të pakicës maqedonase në vend, duke pretenduar se nuk ka dallime etnike midis të dy komuniteteve, ndërsa Shkupi këmbëngul në praninë e një komuniteti të tillë të veçantë, ku flitet për 750,000 maqedonas.

Duke qene se minoriteti maqedonas në Bullgari nuk njihet zyrtarisht si grup i veçantë minoriteti në kuadrin ligjor të vendit. Kjo mungesë e njohjes zyrtare ndikon në aksesin e pakicës në të drejta specifike kulturore, gjuhësore dhe politike. Në fakt, Bullgaria e mbron veten nëpërmjet Kushtetutës, e cila nuk përmend ekzistencën e pakicave kombëtare. Shprehimisht në Nenin 2. Pika (1) thuhet: "Republika e Bullgarisë është shtet unitar me vetëqeverisje lokale. Asnjë formacion territorial autonome nuk do të lejohet të ekzistojë aty".

Kjo nënkupton se ndarja e vendit në rajone të autonomë ose të veçantë është e ndaluar dhe si rezultat, Kushtetuta nuk përmend specifikisht pakicat kombëtare. Kjo i jep të drejtën të mos njohë minoritetin maqedonas në Bullgari, por nga ana tjetër, Sofja zyrtare ia lejon vetës të kërkojë ndryshime kushtetuese për minoritetin bullgar në RMV. Ndonëse në kushtetutën e RMV-së, është i parashikuar qartë neni për garantimin e të drejtave të të gjithë pakicave minoritare në territorin e Maqedonisë së Veriut. Kushtetuta e RMV-së, e ndryshuar në vitin 1991, e garanton dhe




"

**Pretendimet e Bullgarisë**

*Në lidhje me minoritetet janë rizgjuar ethshëm sidmos pas anëtarësimit të saj në Bashkimin Europian, ku pakicat e ndryshme që jetojnë përgjatë kufirit në Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Serbi, u joshen nga pasaporta bullgare, që i mundësonte largimin drejt BE-së. Gjithashtu, Bullgaria ka përdorur ndikimin e saj në Bashkimi Evropian për të adresuar çështjet e minoriteteve dhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të tyre në rajon. Kjo është bërë në kuadër të përpjekjeve për zgjerimin e BE-së dhe integrimin e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor.*

"

e mbron të drejtat e pakicave. Kushtetuta e RMV-së përmend se të gjitha pakicat, duke përfshirë shqiptarët, serbët, turqit, dhe maqedonasit e tjerë, gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta.

Por ndërsa Bullgaria nuk bën asnjë lëshim për të ndryshuar kushtetutën e saj, për të përfshirë minoritetin maqedonas, ajo ben presione duke kushtëzuar integrimin e Maqedonisë së Veriut, ( rrjedhimisht dhe Shqipërisë), për të bërë ndryshimet kushtetuese.

Pra, kjo është një padrejtësi që bëhet në emër të mbrojtjes së minoritetit, ku në fakt, të drejtat e qytetarëve minoritarë duket se nuk janë aspak qëllim në vetvete.

### "Rritja e minoritetit bullgar në Shqipëri dhe rënia e maqedonasve"

Padashur, Shqipëria po bëhet një "vendngjarje" e një "krimi historik", pasojat e së cilës mund ti shohim dekada më vonë.

"Asimilimi" i minoritetit maqedonas, dhe mosnjohja e minoritetit maqedonas në Bullgari, përplasja e RMV-së me Greqinë, na tregon se Maqedonia e Veriut po shkon drejt zhbërjes së saj si komb dhe si shtet.

Pra, nëse i shohim lëvizjet gjeopolitike në rajon dekadën e fundit, shohim se ndryshimet kufitare, janë pjesë e një agjende për të cilen po punohet intensivisht.

Rrënjët e minoriteteve të ndryshme në Shqipëri dhe rajon janë të lidhura me periudhat historike të migrimeve dhe ndryshimeve territoriale në Ballkan, por tashmë, krijimi i këtyre minoriteteve po bëhet përcaktuese për ridefinim të kufijve në Ballkan.

Me këtë frymë ndoshta po tentohet "asimilimi" i minoritetit maqedonas edhe në Shqipëri.

E përcaktoj si asimilues tkurrjen e madhe që ky minoritet pati në shifra zyrtare, ku sipas të dhënave nga CENS 2023, aktualisht jetojnë 2,281 maqedonas, ndërsa në vitin 2011 ishin deklaruar 5,512. Ndërsa për herë të parë është regjistruar edhe minoriteti bullgar, ku numërohen 7,057 bullgarë.

Kjo diferencë e madhe në numra ka shkaktuar akuza dhe reagime të ndryshme për manipulimin e të dhënave të regjistrimit, me dyshime për ndërhyrje nga pala bullgare në këtë proces.

Në fakt që në krye të herës, para dhe gjatë zhvillimit të regjistrimit të popullsisë në Shqipëri, Ambasada e Maqedonisë së Veriut në Tiranë, apo dhe Kryetari i Partisë Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian, Vasil Sterjovski, kanë shprehur pakënaqësi për disa ndërhyrje të paligjshme nga pala bullgare gjatë regjistrimit të popullsisë. Ka patur edhe akuza për presione të drejtpërdrejta ndaj qytetarëve minoritarë maqedonas në Shqipëri.

Por të gjitha këto ankesa kanë shkuar në veshë të shurdhër.

Tashmë minoriteti bullgarë në Shqipëri është një Fakt.

Sikundër është fakt që Bullgaria ka ndërhyrë me ndihma për ata që ajo i quan minoritarë bullgarë, pavarësisht se më përpara ishin maqedonas.

Sikundër është fakt se Shkupi zyrtar, i ka lënë në mëshirë të fatit qytetarët e saj, në Shqipëri.

Ndaj nuk e di sa e drejtë është të drejtosh gishtin ndaj atyre që kanë ofruar ndihmën e tyre për këta qytetarë, (apo manipuluar), qoftë me pasaportë europiane, bursa shkollore, materiale shëndetësore, etj.

Ku ishte Shkupi zyrtar ndërsa është raportuar, folur e shkruar kaq shumë se Bullgaria po ofron ndihmë për minoritetin maqedonas, tashmë maqedonas të bullgarizuar?

Apo dhe në rastin kur është faktuar se po jepen e merren vërtetime në mënyrë të paligjshme që vërtetojnë "origjinën" bullgare.

Kjo nuk do të thotë se Bullgaria po luan pastër, por kjo situatë, padiskutim është krijuar edhe për shkak të neglizhencës maqedonase.

Megjithatë ndërsa tema e Censit dhe rezultateve të saj, është trajtuar tashmë mes reagimeve zyrtare dhe jo zyrtare, nëpërmjet këtij shkrimi dua të fokusohem në faktin se në territorin e Shqipërisë, Bullgaria ka konsoliduar një komunitet prej 7,057 minoritarë bullgarë.

Nisur nga kërkesat e saj për këtë minoritet dhe në vende të tjera të rajonit, lind pyetja: A po përpiqet Bullgaria të zgjasë ndikimin e saj në rajon përmes asaj që njihet si 'soft power'?

Nuk dihet se cili është qëllimi i vërtetë i Sofjes zyrtare në përcaktimin e minoriteteve bullgare në rajon, por shpejtësia, peizazhi gjeopolitik, presioni në emër të BE-së, lë vend për paqartësi dhe ngre pikëpyetje të mëdha.

Ky minoritet lidhet me sfondin historik që në periudhën e ish-Perandorisë Bullgare të Car Samuelit (976-1014), i cili u ngrit kundër Bizantit. Nën sundimin e tij bashkojë krejt Maqedoninë, që nga Selaniku e deri në vargmalet e Ballkanit, për ta zhvendosur me pas qendrën e shtetit Bullgar në Prespë e Ohër.Ëndërra perandorake u shtua dhe në Traktatin

e Shën Stefanit, më 3 Mars 1878, ku Rusia kërkonte të krijonte një Bullgari të Madhe që të shtrihej në lindje nga Deti i Zi, në jug në detin Egje dhe në perëndim në vargmalet e Voskopojës, duke përfshirë krahina të Korçës, Pogradecit, Dibrës, etj.

Nisur nga ky kontekst i dikurshëm historik, por tashmë dhe në emër të Europës dhe votës që Bullgaria ka në familjen europiane, axhendën e saj historike përpos përmbushjes me sukses në Shqipëri, dhe vijimit të presionit që po bëhet ndaj Maqedonisë së Veriut, Bullgaria po e ndjek me përpikmëri edhe në Kosovë dhe Serbi.

Vizitat e fundit të zyrtarëve bullgarë, si zëvendëspresidentja Iliana Iotova dhe presidenti Rumen Radev, kanë forcuar gjithashtu kërkesën për njohjen e komunitetit bullgar në Kosovë.

Sipas Bullgarisë, njohja zyrtare e minoritetit bullgar në Kosovë do të përbënte një vazhdim të politikës së saj shtetërore. Ky hap mund të kontribuonte në përfshirjen e Bullgarisë në kushtetutën e Kosovës si një komunitet jo-shumicë dhe gjithashtu mund të ndihmonte Kosovën të siguronte mbështetje në organizatat ndërkombëtare, ndërsa goranët do të mund të përfitonin pasaporta të Bashkimi Evropian.

E njejta skemë dhe në Serbi.

Presidenti bullgar Rumen Radev ka lënë të kuptohet se Sofja mund të rivlerësojë mbështetjen për anëtarësimin e Serbisë në BE për shkak të mënyrës se si Beogradi e trajton pakicën bullgare në vend. Ai ka theksuar se kriteri kryesor për mbështetje është gjendja e bashkatdhetarëve të bullgarëve në këto vende, duke përfshirë kushtet për zhvillimin e tyre ekonomik dhe social, si dhe mbrojtjen e identitetit të tyre kombëtar, gjuhës, kulturës dhe kujtesës historike.

Ndikimi që po përdorin Bullgaria dhe Greqia me bën të mendoj që po krijohet një linjë e caktuar ortodokse që ka për qëllim të mbrojë interesat e minoriteteve në një mënyrë që shpesh është e lidhur me interesat gjeopolitike të këtyre vendeve. Kjo linjë mund të krijojë një ndarje të rëndësishme në Evropë dhe të ndihmojë në forcimin e ndikimit rus në rajonet që kanë minoritete ortodokse ose ku Rusia ka interes ekonomik dhe strategjik.

Ndikimi që po përdorin Bullgaria dhe Greqia me bën të mendoj që po krijohet një linjë e caktuar ortodokse që ka për qëllim të mbrojë interesat e minoriteteve në një mënyrë që shpesh është e lidhur me interesat gjeopolitike të këtyre vendeve. Kjo linjë mund të krijojë një ndarje të rëndësishme në Evropë dhe të ndihmojë në forcimin e ndikimit rus në rajonet që kanë minoritete ortodokse ose ku Rusia ka interes ekonomik dhe strategjik.

Një linjë që është përmendur tërthorazi edhe nga vetë presidenti i Rusisë Vladimir Putin.

**"Dinamika e irredentizmit bullgar në Ballkan"**

Intensiteti i politikës bullgare në krijimin e minoriteteve bullgare në rajon është shfaqur në mënyra të ndryshme, nëpërmjet strategjive të ndryshme, përfshirë ndihmën ekonomike, edukimin dhe promovimin e kulturës bullgare dhe është arritur të krijohet një prezencë më e fortë dhe më e dukshme e minoriteteve bullgare. Megjithatë, është e rëndësishme që këto përpjekje të menaxhohen me kujdes për të mos rrezikuar marrëdhëniet ndër-rajonale, apo për të mos shkuar drejt një politike nacionaliste.

Thonë se historia përsëritet, sidomos kur ajo harrohet.

Por mjafton të kthehemi në retrospektivë, që të kuptojmë se aktiviteti gjeopolitik bullgar i ka rrënjët në dëshirën për të rimarrë tokat që dikur ishin pjesë e Perandorisë Bullgare ose të lidhura ngushtë me kulturën dhe historinë bullgare.

Ky rajon përfshin pjesë të Greqisë veriore, Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë. Pretendimet historike u nxitën nga prania e bullgarëve etnikë dhe lidhjeve kulturore.

E pra, irredentizmi bullgar lindi në fund të shekullit të 19-të dhe fillim të shekullit të 20-të, kur ideja e bashkimit të të gjithë bullgarëve etnikë nën një shtet ishte një qëllim i rëndësishëm politik. Pretendimet historike, të cilat kanë lindur shekuj më parë, vazhdojnë të ndikojnë në marrëdhëniet rajonale, sidomos përmes pretendimeve të pakicave.

Irredentizmi, pavarësisht nga ku lind është një faktor që minon stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal në Ballkan. Por që ky irredentizëm të mos jehojë në vendet tona, është me rëndësi që historia dhe kufijtë e saj antik të mos shërbejnë si një barrierë për bashkëpunimin dhe paqen, por si një pikë reference për të ndihmuar në krijimin e marrëdhënieve ndërmjet vendeve të Ballkanit.

# Ofensiva e Ukrainës në Kursk është një pikë kthese në luftë



Nga Carl Bildt - Foreign Policy
Ish-kryeministër dhe ministër i jashtëm i Suedisë




"

**Pas dështimit të dukshëm të kundërofensivës së shumëpërfolur të Ukrainës në vitin 2023, presidenti rus Vladimir Putin punoi shumë për të bindur Ukrainën dhe botën se do të ishte vetëm çështje kohe para se avulli rus në mënyrë të pashmangshme të nënshtronte Ukrainën, fshat pas fshati. Putin llogariti se nëse mjaft njerëz do të blejnë këtë narrativë, Ukraina do të detyrohej të dorëzohej përfundimisht dhe të përthithej, pjesërisht ose tërësisht, në Rusinë e tij të madhe.**

Ndërsa forcat ukrainase zgjerojnë zonën e tyre të kontrollit në rajonin e Kurskut të Rusisë në javën e dytë të inkursionit të tyre, është e qartë se ata përfundimisht do të duhet të kthehen në shtëpi. Në fund të fundit, parimi i integritetit territorial është në thelb të luftës së Ukrainës dhe reagimit të fortë ndërkombëtar ndaj përpjekjes së Rusisë për të ndryshuar kufijtë e Evropës përmes pushtimit.

Por kjo nuk është çështja për sot, dhe unë do t'ua lë ekspertëve të vlerësojnë rëndësinë ushtarake të operacionit. Ajo ka demonstruar qartë dobësi të konsiderueshme në mbrojtjen kufitare të Rusisë, ka shkaktuar konfuzion në zinxhirin komandues të Moskës dhe ka vërtetuar talentin e vazhdueshëm të Ukrainës për lëvizje befasuese.

Por luftërat janë politike si dhe ushtarake, dhe është në arenën politike ku inkursioni i Ukrainës në Kursk ka ndryshuar rrënjësisht rrjedhën e konfliktit.

Pas dështimit të dukshëm të kundërofensivës së shumëpërfolur të Ukrainës në vitin 2023, presidenti rus Vladimir Putin punoi shumë për të bindur Ukrainën dhe botën se do të ishte vetëm çështje kohe para se avulli rus në mënyrë të pashmangshme të nënshtronte Ukrainën, fshat pas fshati. Putin llogariti se nëse mjaft njerëz do të blejnë këtë narrativë, Ukraina do të detyrohej të dorëzohej përfundimisht dhe të përthithej, pjesërisht ose tërësisht, në Rusinë e tij të madhe.

Strategjia e Putinit ka pasur njëfarë suksesi. Përpjekja e ushtrisë ruse për një ofensivë të madhe në rajonin e Kharkiv disa muaj më parë u dështoi shpejt; Forcat ruse ende nuk duken të afta për atë lloj përpjekjeje kundër mbrojtësve të rrënjosur. Por gjatë verës, forcat e Putinit kanë bërë fitime në rritje përgjatë vijës së frontit të Donbasit me



koston e humbjeve të jashtëzakonshme në jetë dhe pajisje ruse. Asnjë nga këto arritje nuk ka pasur ndonjë rëndësi të madhe ushtarake, por ato ishin të mjaftueshme për t'i dhënë një monedhë besueshmërie narrativës së Putinit për të shkatërruar gradualisht mbrojtjen e Ukrainës.

Dhe më pas, si një rrufe në qiell, vjen ofensiva e Kurskut, duke shkatërruar atë që Putini është përpjekur të ndërtojë. Udhëheqësi rus është qartë i tronditur. Gjatë një sërë takimesh të mbledhura me nxitim me këshillin e tij të sigurisë dhe këshilltarët e tjerë, ai po përpiqet të minimizojë sukseset e Ukrainës duke i quajtur ato një "provokim", duke i këshilluar guvernatorët rajonalë që të mos përmendin madhësinë e zonës së kontrollit të Ukrainës, duke parë ashpër ushtrinë e tij. komandantët dhe duke u përpjekur të duken të patrazuar nga kthesa e papritur e ngjarjeve.

Ne e dimë se Putin ndonjëherë ka një pamje të shtrembëruar të realitetit. Por ai me siguri e kupton se nëse forcat e tij nuk i kthejnë shpejt ukrainasit përtej kufirit, kjo do të jetë një goditje vdekjeprurëse për linjën narrative dhe politike që ai është përpjekur të ndërtojë me kujdes – dhe me kosto të madhe – që nga vera e kaluar.

Ndërsa komanda ruse ende përpiqet të ridislokojë forca të mjaftueshme në Kursk për të frenuar pushtimin – e lëre më ta mposht atë – është e qartë se operacioni i shpejtë i Ukrainës në Kursk tashmë ka kapur shumë më tepër terren sesa kundërsulmimi i pasuksesshëm i 2023-ës. Forcat ukrainase gjithashtu duket se kanë qenë më të suksesshme gjatë tre ditëve në Kursk sesa forcat ruse gjatë tre muajve në Kharkiv. Është një kthesë në fatin e Ukrainës, po aq dramatike sa kemi parë në garën presidenciale të SHBA-së që nga kandidatura e Zëvendës Presidentes Kamala Harris: Papritur, gjithçka duket ndryshe.

Ukraina mund të ketë kapur rreth 1,000 kilometra katrorë të territorit rus, Moska ka evakuuar më shumë se 100,000 njerëz nga zona dhe një numër i madh ushtarësh rusë duket se janë dorëzuar pa luftë. Megjithatë, rezultati kryesor i ofensivës nuk është në fushat e betejës në rajonin e Kurskut, por në mjediset politike të Kievit dhe Moskës.

Morali dhe vendosmëria janë rritur në të parën, dhe dyshimet dhe pasiguritë janë shtuar në të dytën. Dhe kryeqytetet perëndimore po zgjohen me një realitet të ri në luftë.

Është demonstruar se lufta nuk është një rrugë e gjatë dhe e dhimbshme drejt një disfate të pashmangshme të Ukrainës – linja e Kremlinit që është bërë jehonë nga shumë në Perëndim, duke përfshirë edhe kandidatin republikan për zëvendëspresidentin e SHBA-së, J.D. Vance – por shumë një çështje e hapur. /FP/

**Përshtati në shqip:**
**Argumentum.al**

## "SHQIPËRIA NË QENDËR TË VËMENDJES"

# Kryeministri Rama: Mikpresim Samitin e NATO-s në 2027. Samitin e komunitetit politik në 2025. Perspektiva për BE në vitin 2030

Konferenca e Ambasadorëve "Tirana Diplo 2024" nisi sot(26 gusht) punimet në Tiranë, nën organizimin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, dhe me pjesëmarrjen e Ambasadorëve dhe Konsujve të Përgjithshëm të Shqipërisë nëpër botë, – për të diskutuar gjerësisht mbi angazhimin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, sfidat e diplomacisë shqiptare në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian, zhvillimet rajonale dhe të sigurisë, diplomacinë ekonomike, kulturore dhe turizmin.

Kryeministri Edi Rama deklaroi sot se Shqipëria është bërë pikë referimi në politikën e jashtme, ndërsa do të mikpresë vitin e ardhshëm Samitin e Komunitetit Politik Europian dhe Samitin e NATO-s në vitin 2027.

Në hapje të punimeve të Konferencës Vjetore të Ambasadorëve të Shqipërisë, Rama vlerësoi se prej kohësh Shqipëria nuk është statike në pozicionimin dhe në qasje ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare.

"Si rezultat i qëndrimit dhe veprimit të vazhdueshëm dinamik është edhe fakti deri para disa vitesh i paimagjinueshëm i marrjes nga Shqipëria të një sërë përgjegjësisë shumë të rëndësishme në arenën ndërkombëtare, duke nisur nga kryesimi i Procesit të Berlinit ku arritëm disa rezultate domethënëse në funksion të Planit të ri të Rritjes", tha Rama.

Kryeministri solli në vëmendje edhe Samitin BE-Ballkani Perëndimor që për herë të parë u mbajt




jashtë hapësirës së BE-së, në Tiranë. "Po ashtu kemi hapjen e Kolegit të Europës në Tiranë, i cili tanimë është një realitet i prekshëm dhe viti i parë akademik i Kolegjit është në fillimin e tij, pasi është bërë edhe seleksionimi i studentëve nga të gjitha vendet e Europës. Kishte një kërkesë shumë më të lartë se sa parashikimi", shtoi Rama.

Kryeministri veçoi edhe rolin e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

"Këtu e kam të rëndësishme të sjell një shembull për të treguar se sa i rëndësishëm është roli proaktiv i ambasadorëve. Shembullin e ambasadorit tonë në Kombet e Bashkuara, i cili tanimë shërben si ambasador në Bruksel, për të lehtësuar të gjithë ndërveprimin e jashtëzakonshëm që kemi me Brukselin. Falë edhe lidershipit të të cilit Shqipëria ushqeu shumë respekt, krijoi shumë besim dhe padiskutim mori një prestigj që nuk e kishte pasur më parë", tha Rama.

Kryeministri theksoi se pikërisht ky respekt, besim e prestigj na bën sot që të jemi vendi që do të mikëpresë liderët e 44 shteteve europiane, nga Britania e Madhe deri në Ukrainë, apo nga Suedia e Norvegjia deri në Turqi vitin e ardhshëm, në samitin e Komunitetit Politik Europian.

"Ky respekt, besim, prestigj dhe roli i një tjetër ambasadori që e sjell këtu si një shembull jo për ta veçuar nga të tjerët, por për të nënvizuar se sa e rëndësishme është për ne që të përfaqësohemi me volumin maksimal të ambicies, por edhe të aftësisë për të qenë të respektueshëm, gjë që na jep mundësinë të jemi mikpritës të samitit të NATO-s në vitin 2027", tha Rama.

Kryeministri theksoi se "as nuk mund të imagjinohej disa vite më parë që Shqipëria të bëhej pikë referimi dhe t'i besoheshin të tilla role".

"Aq shumë ka ndryshuar në këtët aspekt raporti i botës me ne saqë po bëhet natyrshëm edhe jo e lehtë për t'i numëruar të gjitha. Sepse mund pa dashje të harrohen. Se ndërkohë kemi pasur edhe kryesimin e OSBE-së, ku falë një tjetër ambasadori që sot është ministër i Jashtëm, dhe jo rastësisht është kërkuar nga një pjesë e madhe e vendeve të OSBE-së për të kandiduar për rolin e Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, ne kemi pasur një tjetër mundësi të shfrytëzuar në mënyrën më të mirë, ku përsëri kemi ushqyer besim dhe kemi rritur prestigjin e vendit tonë", tha Rama.

# Drejtori i CIA-s takon lidershipin e Kosovës



Drejtori i Agjencisë Qendrore amerikane të Zbulimit (CIA), William Burns, u takua të premten në Prishtinë me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, i cili është kthyer nga Shtetet e Bashkuara, ku mori pjesë në Kuvendin e demokratëve në Çikago.
Të enjten zoti Burns u takua me dyer të mbyllura me Presidenten e Kosovës Vjosa Osmani si dhe me institucionet e sigurisë. Nuk janë dhënë hollësi rreth vizitës, ndërsa presidentja Osmani në një postim në Facebook shkroi se "Aleanca me Shtetet e Bashkuara, garancë për siguri, paqe e sukses"!

Vizita e zotit Burns ndodh në një kohë kur qeveria amerikane ka kundërshtuar vendimet për veriun e Kosovës të kryeministrit Albin Kurti dhe ka vlerësuar se ka rënie të cilësisë së marrëdhënieve ndërmjet dy qeverive.
Në një njoftim të qeverisë së Kosovës, thuhet ndërkaq se vizita e zotit Burns "përfaqëson një moment të rëndësishëm historik" në marrëdhëniet dypalëshe,
"Vizita historike e Drejtorit të CIA-s, z. William Burns, në Kosovë, vlerësohet lartë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ajo është dëshmi e marrëdhënieve të forta dhe të qëndrueshme midis dy shteteve dhe është një mundësi e artë për të thelluar bashkëpunimin strategjik, për paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë", thuhet në njoftim.

**Njoftimi i qeverisë së Kosovës:**
*Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, sot priti në takim Drejtorin e CIA-s, William Burns.*
*Kjo vizitë përfaqëson një moment të rëndësishëm historik në marrëdhëniet bilaterale Kosovë – ShBA, ku u theksua përkushtimi i Qeverisë dhe institucioneve të sigurisë dhe inteligjencës së Kosovës, me në krye AKI-në, për të avancuar bashkëpunimin me CIA-n.*
*Vizita historike e Drejtorit të CIA-s, z. William Burns, në Kosovë, vlerësohet lartë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ajo është dëshmi e marrëdhënieve të forta dhe të qëndrueshme midis dy shteteve dhe është një mundësi e artë për të thelluar bashkëpunimin strategjik, për paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë.*
*Kryeministri Kurti e falënderoi Drejtorin e CIA-s për mbështetjen e vazhdueshme dhe shprehu përkushtimin për thellimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, duke e njoftuar atë që vlerat amerikane, që ndërlidhen me demokracinë, sundimin e rendit dhe ligjit dhe orientimet e palëkundura Euro-atlantike, do të mbeten shtyllat qendrore të qeverisjes së mirë e demokratike në Kosovë.*
*Kryeministri Kurti e njoftoi Drejtorin Burns me rritjen dhe zhvillimin ekonomik si dhe progresin shoqëror e demokratik të Kosovës, duke theksuar që*

*të gjitha sfidat e brendshme të sigurisë po menaxhohen suksesshëm me forcën e ligjit të drejtë të shtetit tonë demokratik. Në këto tri vitet e fundit, ai shtoi që Bruto Produkti Vendor i Kosovës është rritur për 33% kurse buxheti shtetëror për 35%, me ç'rast 11.1% (apo 1/9) e buxhetit vjetor i dedikohet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes.*

Zoti Burns arriti në Prishtinë, në kuadër të një vizite në rajon gjatë së cilës qëndroi edhe në Sarajevë dhe në Beograd.

Nuk pati asnjë njoftim për takimet e tij në Serbi, ndërsa të martën zoti Burns takoi në Sarajevë zyrtarë politikë dhe të agjencive të sigurisë, në një vizitë gjatë së cilës, sipas një zyrtari të qeverisë amerikane, u diskutua lidhur me retorikën përçarëse dhe veprimet e presidentit pro rus të Republikës Serbe, Milorad Dodik.

Milorad Dodiku gëzon përkrahjen e Rusisë për qëndrimet e tij, ndërsa ekziston një frikë e përhapur në Perëndim se Moska po përpiqet të destabilizojë Bosnjën dhe pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor, për të zhvendosur të paktën një pjesë të vëmendjes botërore nga agresioni i saj në Ukrainë.

> Kryeministri Kurti e falënderoi Drejtorin e CIA-s për mbështetjen e vazhdueshme dhe shprehu përkushtimin për thellimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, duke e njoftuar atë që vlerat amerikane, që ndërlidhen me demokracinë, sundimin e rendit dhe ligjit dhe orientimet e palëkundura Euroatlantike, do të mbeten shtyllat qendrore të qeverisjes së mirë e demokratike në Kosovë.



Ajo që ra në sy pas vizitës së zotit Burns në Sarajevë, ishte se Milorad Dodiku shkroi në rrjetet sociale se "Republika Serbe kurrë nuk e ka vënë në pikëpyetje sovranitetin dhe tërësinë tokësore të Bosnjës dhe Hercegovinës në përputhje me Marrëveshjen e Dejtonit dhe shkëputja nuk ka qenë kurrë politika jonë".

Por, shkroi ai, Republika Serbe ka të drejtë të zhvillojë luftë politike për statusin e saj, sipas Marrëveshjes së Dejtonit.

"Bosnja dhe Hercegovina është bashkim i dy entiteteve të barabarta dhe tre popujve përbërës, prandaj është inkurajues qëndrimi i zotit Burns se përgjegjësia për funksionimin e vendit është e të gjitha bashkësive etnike", shkroi ai.

Të enjten Milorad Dodiku u prit në Beograd nga Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç në një takim, gjatë të cilit, siç u tha, të dy bënë "një analizë të përbashkët të çështjeve globale dhe rajonale".

Milorad Dodiku është nën sanksione nga Shtetet e Bashkuara dhe Britania. Shtetet e Bashkuara thonë se ai e ka dëmtuar Marrëveshjen e Paqes të Dejtonit të vitit 1995, e cila i dha fund luftës së Bosnjës të viteve 1992-1995, që shkaktoi vdekjen e mbi 100,000 vetëve dhe zhvendosjen e miliona të tjerëve. Në përfundim të luftës Bosnja u nda në dy rajone autonome, Republikën Serbe dhe Federatën Boshnjako-Kroate, të lidhura nëpërmjet një qeverie të dobët qendrore në Sarajevë.

# Maqedoni e Veriut/ Shënohet 23-vjetori i Marrëveshjes së Ohrit



Në Maqedoninë e Veriut, partitë shqiptare të pushtetit dhe ato në opozitë po e shënojnë 23 vjetorin e Marrëveshjes së Ohrit të ndara dhe me akuza ndaj njëra tjetrës për mënyrën e zbatimit të saj. Në të vërtetë, marrëveshja që i dha fund konfliktit të armatosur midis kryengritësve shqiptarë të ish-Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe forcave ushtarake e policore maqedonase dhe solli paqen e brishtë në vitin 2001, duhej zbatuar deri në vitin 2004, por edhe pas 23 vjetësh nga nënshkrimi i saj, ende ka ankesa se ky dokument nuk po zë vend në praktikë në të gjitha fushat.

Ali Ahmeti i Bashkimit Demokratik për Integrim, i cili atë kohë ishte drejtues politik dhe ushtarak i ish-Ushtrisë Çlitimtare Kombëtare dhe bashkërendonte qëndrimet me drejtuesit politikë shqiptarë në bisedime, sot ka përshtypjen se pushteti po heq dorë nga Marrëveshja e Ohrit, për shkak të heqjes së atij që njihet si balansues dhe që synonte sistemimin e nëpunësve në adminstratën shtetërore sipas përkatësisë etnike në bazë të përqindjes së popullatës dhe për shkak të emërimit për ministër të Marrëdhënieve me Komunitetet të një pjesëtari të komunitetit serb i dyshuar për afërsinë me presidentin serb Aleksandar Vuçiç dhe me shërbimet inteligjente serbe e ruse:

*"Prandaj, ne jemi dalëzotës të dinjitetit tonë kombëtar dhe të shtetformimit të mirëfilltë të Republikës tonë që ne nuk shohim të ardhme diku tjetër, sepse nuk jemi të dyndur dhe të ardhur nga ndonjë vend i largët, por vijmë gjysh-pas-gjyshi, bashkë me diellin në këto hapësira. Fatet e këtij vendi i ndajmë bashkë me komunitetin maqedonas, dhe bashkë do të jemi më të fortë"*, u shpreh zoti Ahmeti.

Fronti Evropian, ku bën pjesë edhe krahu i Aleancës për Shqiptarët i zotit Ziadin Sela, vlerëson se në vend po bëhen përpjekje për rrënimin e paqes që e arriti Marrëveshja e Ohrit:

*"Ne do të mbrojmë atë që quhet paqe; ne do të mbrojmë atë që u arrit nëpërmjet Marrëveshjes kornizë të Ohrit, por në të njejtën kohë ne do të veprojmë sipas një ndër postulateve kryesore që Marrëveshja e Ohrit ka. Marrëveshja e Ohrit ishte marrëveshje që u bë për të drejtën, dinjitetin, lirinë dhe barazinë e qytetarëve"*, theksoi zoti Sela.

Fronti Evropian tash me kalimin në opozitë, synon ndryshimin e sistemit shtetëror dhe bërjen sipas modelit të Belgjikës, Irlandës Veriore dhe Zvicrës.

Partitë e Frontit Evropian me BDI-në në krye nuk pranuan të bëheshin pjesë e shënimit të përvjetorit të kësaj ngjarjeje të organizuar nga qeveria.

Në fjalimin e mbajtur në seancë, kryeministri Hristijan Mickoski, tha se miratimi i marrëveshjes kornizë në atë kohë nuk e ka gëzuar dhe kënaqur plotësisht asnjërën nga palët nënshkruese, por se, siç tha ai, "marrëveshja kornizë solli atë që ishte më së shumti e nevojshme dhe e kërkuar në atë moment, e ajo është paqja".

Duke theksuar se janë të ndryshëm për nga përkatësia etnike dhe fete nuk i bën ato të ndryshëm për sa i përket nevojave dhe prioriteteve, Mickoski tha: "Nevoja dhe prioriteti kryesor i të gjithëve është një jetë më e mirë. Kemi probleme të njëjta, të përbashkëta, prandaj bashkërisht duhet të ofrojmë zgjidhje dhe t'i zgjidhim ato probleme".

Ai tha se Maqedonia e Veriut është atdheu i tyre i përbashkët të cilin duhet ta ndërtojnë së bashku. "Të punojmë për t'i besuar njëri-tjetrit. Jam i sigurt se do të arrijmë të bëjmë më shumë për çdo person. Marrëdhëniet ndëretnike janë shtylla kurrizore e shoqërisë sonë të përbashkët. Nuk janë vetëm detyrime ligjore apo marrëveshje politike. Ato janë një proces i gjallë që kërkon vazhdimisht përkushtimin dhe angazhimin tone", u shpreh Mickoski.

Zëvendëskryeministri i parë dhe Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Izet Mexhiti, nga ana e tij, duke theksuar se qeveria e re "nuk është vetëm në fjalë por edhe në veprim", tha se "Kjo qeveri dëshmon kapacitet për vlerat dhe frymën e Marrëveshjes së Ohrit".

Marrëveshja e Ohrit qe nënshkruar dhe nga përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar, ambasadori James Pardew si i dërguar i Shteteve të Bashkuara dhe François Leotard, i dërguar i Bashkimit Evropian.

Edhe tre nga drejtuesit politik në Maqedoninë e Veriut të përfshirë në arritjen e këtij dokumenti paqësor Arbën Xhaferi, Imer Imeri dhe Boris Trajkovski nuk jetojnë më, ndërsa Branko Cërvenkovski dhe Lubço Georgievski nuk janë aktivë në politikë.

Megjithatë, partitë politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut në veçanti vazhdojnë ta shikojnë komunitetin ndërkombëtar si garantuesin kryesor të realizimit të marrëveshjes.

# "Përshkallëzimi në Lindjen e Mesme: Si po e përfshin Izraeli Libanin në Luftë dhe Roli Strategjik i SHBA-së"




Ndërsa gjendemi sot dhjetë muaj nga lufta midis Izraelit dhe Hamasit në Rripin e Gazës me një bilanc gati genocidal për nga mënyra e sulmeve brutale ku aktualisht që nga 7 tetori numërohen 39,699 palestinezë të vrarë në Gaza dhe 91,722 të plagosur, sipas ministrisë së shëndetësisë së Gazës (përditësimi fundit, 8 gusht 2024), flakët e luftës rrezikojnë të përhapen në gjithë Lindjen e Mesme.

Vrasjet e liderëve të Hamasit dhe Hezbollahut kanë rritur mundësinë e përshkallëzimit të konfliktit dhe kanë ndikuar në rritjen e tensioneve me përfshirjen e aktorëve të tjerë që deri tani ishin në prapavijë duke e bërë krizën rajonale edhe më komplekse dhe të rrezikshme.

Në intervale të ndryshme kohore, që nga 7 tetori 2023, kemi parë përshkallëzime të rrezikshme ushtarake në të gjithë Lindjen e Mesme – përleshje vdekjeprurëse në kufirin izraelito-libanez, sulme të Houthi-ve në Detin e Kuq dhe në Tel Aviv, sulme nga milicitë e linjës iraniane kundër forcave amerikane në Irak dhe Siri, madje edhe përleshje të drejtpërdrejta midis Izraelit dhe Iranit.

Grupet e mbështetura nga Irani nga Libani, Jemeni, Iraku dhe Siria janë tërhequr tashmë në luftën gati 10-mujore të Izraelit në Gaza.

Ndërsa ajo që ka vënë në gjendje alerti qeveritë perendimore, është Vrasja e Haniyeh në Teheran, që vjen vetem disa orë pas vrasjes izraelite të shefit ushtarak të Hezbollahut, Fuad Shukr në Bejrut, dhe ka shkaktuar premtime hakmarrjeje nga Irani dhe i ashtuquajturi "bosht i rezistencës".

Me sytë nga Irani por me vigjilencë të theksuar nga fqinji tjetër, Libani, Izraeli po pret në çdo orë një sulm të mundshëm të koordinuar nga Hamasi dhe grupi libanez Hezbollah.

Hamas është grupi kryesor që udhëheq operacionet dhe përballjet me Izraelin nga Gaza dhe ka rol të drejtpërdrejtë në

konfliktet e përditshme në atë rajon, ndersa Hezbollah, ka fokusin e tij kryesor në Liban dhe konfliktet me Izraelin nga ky territor, ka ofruar ndihmë dhe mbështetje për Hamas si një pjesë e strategjisë së tij dhe të aleatëve të tij, përfshirë Iranin dhe Sirinë. Këto marrëdhënie dhe ndihma ndërmjet grupeve militante ndihmojnë në ndërlikimin dhe zgjatjen e konflikteve në rajon.

Një nga faktorët kryesorë që mund të kontribuojnë në përshkallëzim është pikërisht përfshirja e drejtpërdrejtë e Hezbollahut nga Libani. Ky grup militant shiit ka një histori të gjatë të përplasjeve me Izraelin dhe është një lojtar kyç në Lindjen e Mesme. Veprimet e tij mund të nxjerrin një përgjigje të ashpër nga Izraeli, e cila mund të çojë në një konflikt të mëtejshëm. Përveç Hezbollahut, Irani, që ka mbështetur grupet militante, gjithashtu është një faktor i rëndësishëm në këtë skenar. Aktivizimi i mëtejshëm i Iranit në këtë situatë shton tensionet dhe rrit përshkallëzimin e konfliktit në një nivel më të gjerë.

Kujtojmë se Grupi libanez Hezbollah, një aleat i grupit palestinez Hamas, dhe ushtria izraelite kanë shkëmbyer zjarrin ndërkufitar që nga fillimi i sulmit izraelit në Gaza në tetor, pasi Hamasi udhëhoqi një sulm të rrallë brenda territorit izraelit, duke vrarë rreth 1,139 njerëz dhe duke marrë rreth 240 të tjerë robër.

Por tashmë situata është më e rrezikshme.

Disa qeveri perëndimore, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar dhe Francën, u kanë bërë thirrje qytetarëve të tyre që të largohen menjëherë nga Libani pasi tensionet po rriten në Lindjen e Mesme pas vrasjes së shefit politik të Hamasit, Ismail Haniyeh, për të cilin Irani fajësoi Izraelin dhe SHBA-në.

Javen e parë të gushtit, aleati i Izraelit, SHBA, tha se do të lëvizte anije luftarake dhe avionë luftarakë shtesë në rajon dhe u kërkoi qytetarëve të tij në Liban të largoheshin me "çdo biletë në dispozicion".

Ambasada e SHBA-së në Bejrut u kërkoi shtetasve të saj që të "përgatisin plane emergjence" nëse zgjedhin të qëndrojnë në Liban dhe të jenë të përgatitur të "strehohen në vend për një periudhë të gjatë kohore".

Zyra e Jashtme e Mbretërisë së Bashkuar gjithashtu u bëri thirrje qytetarëve të saj në Liban që të largohen "tani ndërsa opsionet tregtare mbeten të disponueshme".

"Tensionet janë të larta dhe situata mund të përkeqësohet me shpejtësi", tha në një deklaratë Sekretari i Jashtëm britanik, David Lammy. "Ndërsa ne po punojmë gjatë gjithë orarit për të forcuar praninë tonë konsullore në Liban, mesazhi im për shtetasit britanikë atje është i qartë – largohuni tani".

Mbretëria e Bashkuar konfirmoi gjithashtu se anëtarët e familjes së stafit të ambasadës së saj në Bejrut ishin "tërhequr përkohësisht".

Të dielën,(4 gusht) Ministria Franceze për Evropën dhe Punët e Jashtme iu beri thirrje qytetarëve te saj në Liban të largohen "sa më shpejt të jetë e mundur" për shkak të rrezikut të një përshkallëzimi ushtarak.

I gjithë ky shqetësim dhe angazhim i Perëndimit për largimin e menjëhershëm të qytetarëve të saj nga Libani është tregues se aktualisht situata në Lindjen e Mesme është jashtëzakonisht e tensionuar dhe e rrezikshme, me përshkallëzimin e konflikteve që rrezikon të përfshijë jo vetëm Libanin në luftë por dhe të shkaktojë një krizë të plotë rajonale dhe ndërkombëtare.

Por kush është duke e përfshirë Libanin në luftë dhe çfarë ndikimi mund të ketë ky përshkallëzim në stabilitetin rajonal dhe ndërkombëtar?

### Përfshirja e Libanit në konflikt me Izraelin

Libani është në një krizë të thellë ekonomike dhe politike, dhe kjo e bën vendin më të ndjeshëm ndaj përshkallëzimeve të jashtme. Izraeli po shikon mundësi për të vepruar për të ndikuar në këtë situatë dhe për të shfrytëzuar paaftësitë e brendshme të Libanit.

Libanezet janë duke përjetuar një periudhë të vështirë dhe të pasigurt. Kujtojmë se Libani ka vite që është në agoninë e krizës ekonomike dhe politike që ka nisur rreth vitit 2019.

Shpërthimi katastrofik i 4 gushtit 2020 në portin e Beirutit, i shkaktuar nga depozitimi i paautorizuar i 2,750 ton materialeve eksplozive (nitrate amoniumi), i cili shkatërroi një pjesë të madhe të qytetit dhe la të vdekur më shumë se 200 persona, me qindra të tjerë të lënduar dhe shumë të pastrehë, e thelloi dhe më shumë këtë krizë.

Ajo nxiti një përshkallëzim të krizës mes protestave te medha

duke kaluar përmes një periudhe të paqëndrueshme politike me qeveri të ndryshme që kanë ardhur dhe ikur.

Por tani gjendet sërish buzë greminës, gati për tu përfshirë ose në rrezik për ta përfshirë këtë vend tashmë të gjunjëzuar në kofliktin me Izraelin.

Sot, Libani është në një gjendje të brishtë dhe është në rrezik të përfshihet në një konflikt me Izraelin. Sikundër e përmendëm, Hezbollah, një grup militant dhe aktor kryesor në politikën libaneze, ka një ndikim të rëndësishëm në jetën politike, duke ndihmuar në stabilitetin e vendit por gjithashtu duke kontribuar në tensionet dhe ndasitë brenda shoqërisë libaneze. Është pikërisht ky grup në shënjestren e Izraelit që po tërheq Libanin në luftë.

Në fund të korrikut, Kabineti i Sigurisë i Izraelit autorizoi kryeministrin Benjamin Netanyahu dhe ministrin e Mbrojtjes Yoav Gallant të vendosnin veprime kundër Hezbollahut, duke kërcënuar me një "çmim të lartë" për sulmin me raketa që synonte një fushë futbolli në Lartësitë Golan, ku u vranë 12 fëmijë. Megjithëse Hezbollah mohoi përfshirjen në këtë sulm. SHBA-ja ka deklaruar se nuk dëshiron përshkallëzimin e situatës, megjithëse ka dërguar forca në Lindjen e Mesme për të mbështetur Izraelin pas sulmit të 7 tetorit ndaj Izraelit dhe fillimit të luftës në Gaza.

Por ajo që ka rritur rrezikun për përfshirjen e Libanit në këtë konflikt, është vrasja e liderit politik të Hamasit Ismail Haniyeh në Teheran dhe vrasja e komandantit të lartë të Hezbollahut Fuad Shukr në Beirut, duke rrezikuar përshkallëzimin e mëtejshëm dhe çdo përpjekje për armëpushim dhe de-përshkallëzim rajonal.

**Izraeli tenton të bëjë "palë " SHBA-të në luftën ndaj Palestinës**

Në një kohë kur në Gaza numërohen çdo ditë me dhjetra-qindra viktima civilë palestinezë, përfshirë gra dhe fëmijë, retorika e Benjamin Netanjahut, Kryeministrit izraelit, ka ngjallur shqetësime të mëdha. Në vizitën e tij në Kongresin amerikan, Netanjahu e quajti luftën në Gaza si "luftën tonë", duke e lidhur atë drejtpërdrejt me interesat e SHBA-së dhe duke deklaruar se "fitorja jonë do të jetë fitorja juaj".

Një togfjalësh i rrezikshëm, ndërsa shohim se urrjetja, pasiguria, frika, dëshpërimi ka kapluar mijëra palestinezë të cilët vetë ekzistenca e tyre është kthyer në kërcënim për Izraelin.

Dihet se SHBA-ja, është një aleat strategjik, dhe mbështetja kryesore e Izraelit, e cila as në këtë lufte 10 mujore, ku me mijëra njerëz të pafajshëm kanë humbur jetën në mënyrë çnjerëzore nuk e ka kursyer mbështetjen e saj. Të mos flasim pastaj, për vuajtjet që po perjeton sot çdo palestinez që gjendet në Gaza ku u mohohet çdo e drejtë njerëzore.

E megjithate, Netanjahu, nuk ndalet.

Në fjalimin e tij para Kongresit amerikan, kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu i bëri thirrje SHBA-ve të qëndrojnë me Izraelin dhe u zotua se vendi do të bëjë "çfarëdo që duhet" për të mposhtur Hamasin dhe për të kthyer pengjet e mbetura nga Gaza.

Ai i kërkoi Kongresit të përshpejtojë ndihmën ushtarake shtesë ndërsa lufta në Gaza i afrohet 10 muajve.

Ai theksoi se SHBA kishte ofruar ndihmë të jashtëzakonshme për Izraelin për dekada dhe kërkoi që kjo ndihmë të përshpejtohej për të mposhtur Hamasin dhe për të sjellë në shtëpi pengjet e mbetura. Netanjahu përdori një citat të Winston Churchill-it për të inkurajuar SHBA-në të ofronte ndihmën e saj më të shpejtë, duke e bërë këtë si një kërkesë për mbështetje të vazhdueshme. Heshtja e SHBA-së, është më vrastare se sa vetë fjalët e Netanjahut. Ai zgjati dorën për mbështetje në luftën kundër Palestinezëve, nga qeveria amerikane, dhe mesa duket SHBA-të nuk po e kursejnë ndihmën e tyre karshi egos së Izraelit. "Na jepni mjetet dhe ne do ta përfundojmë punën", thërriste Netanjahu, duke e bërë dhe SHBA përgjegjëse për mijëra viktima të pafajshëm.

Por a rrezikojnë SHBA-të, që me përfshirjen e tyre në Lindjen e Mesme, flakët e luftës të djegin këtë rajon, madje të përfshijnë këtu dhe lojtare të tjerë globale. Dihet se Rusia, Kina, Irani, Turqia nuk mund të mos reagojnë. Madje, kjo do minonte dhe vetë mundësinë historike për një pajtim mes Izraelit dhe Arabisë Saudite, një tjetër aleat me rëndësi për SHBA.

Duhet thënë se Arabia Saudite ka theksuar se vrasja e kreut të Byrosë Politike të Hamasit, Ismail Haniyeh, gjatë vizitës së tij në Teheran, është një shkelje e hapur e sovranitetit të Iranit

dhe përbën kërcënim për paqen dhe sigurinë rajonale.
Përpjekjet e Netanjahut për të lidhur interesat e SHBA-së me ato të Izraelit, heshtja dhe qëndrimi i SHBA-së në këtë situatë janë parë si një mbështetje për veprimet e Izraelit, që i shton shqetësimet për një përshkallëzim të mëtejshëm të konfliktit.
SHBA-të me këtë përfshirje rrezikojnë të humbasin rolin e tyre si ndërmjetës, si negociatorë të paqes, po humbasin besimin e një aleati në Lindjen e Mesme dhe mbi të gjitha po humbin shpresën për një paqe të dëshiruar tashmë shekullore në Lindjen e Mesme.

**Roli i SHBA-së dhe ndikimi i saj në konflikt**

SHBA, një aleate e fortë e Izraelit, i ka ofruar mbështetje diplomatike dhe politike në arenën ndërkombëtare. Kjo mbështetje është pasqyruar shpesh në vetot e SHBA-së në Këshillin e Sigurimit të OKB-së kundër rezolutave që kritikojnë veprimet e Izraelit. Kjo ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në aftësinë e komunitetit ndërkombëtar për të ndërmarrë hapa të fuqishëm në adresimin e krizave në Gaza.
Një dështim i organizatës më të madhe të sigurise siç është OKB dhe Këshilli i Sigurimit, megjithatë kjo është një temë tjetër që duhet trajtuar.
Gjithsesi mbetet jetike çdo angazhim për armëpushim në Gaza. Në këtë moment kritik për stabilitetin rajonal, përpjekjet e SHBA-së për të ndihmuar në arritjen e një armëpushimi në Gaza janë të domosdoshme për të parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të konfliktit përfshirë, Jemenin(Houthi) Libanin( Hezbollah) dhe Iranin( Hamas), dhe sigurisht për të shmangur përfshirjen e trupave amerikane.
Duhet thënë se pritshmëritë që SHBA do ndalonte këtë marrëzi në Lindjen e Mesme kanë qenë të mëdha, sikundër ekzistojnë ende pritshmëritë se Po, SHBA-të mund të bëjnë më shumë për të arritur një armëpushim në një konflikt në të cilin aleati i tij Izraeli ka vrarë pothuajse 40,000 palestinezë, duke kërcënuar të djegë një rajon tashmë të paqëndrueshëm.
Por SHBA-ja ka dështuar të aplikojë presion të mjaftueshëm për de-përshkallëzim dhe ka ndihmuar përkeqësimin e situatës përmes mbështetjes për Izraelin.
Raed Jarrar, drejtor i avokimit në Democracy for the Arab World Now (DAWN), e kritikon politikën e SHBA-së si të papërshtatshme dhe kontradiktore me veprimet e saj. Ai argumenton se SHBA mund të kishte ndaluar transferimin e armëve për të përshpejtuar një armëpushim, duke kontribuar kështu në zbutjen e situatës. Sipas Jarrar, ndihma ushtarake dhe mbështetja politike e SHBA-së për Izraelin ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në aftësinë e Izraelit për të realizuar veprime agresive që kanë kontribuar në përkeqësimin e situatës në rajon.
Jarrar thekson se Izraeli ka pasur një mbështetje të konsiderueshme nga SHBA, e cila ka mundësuar që vendi të përshkallëzojë konflikte në mënyrë që rajoni të mbetet në një gjendje tensioni të lartë. Ai sugjeron se SHBA, përmes ndalimit të ndihmës ushtarake dhe të armëve, mund të kishte ndihmuar në frenimin e përshkallëzimit të konflikteve dhe në arritjen e një armëpushimi më të hershëm.
"Izraeli nuk mund të kishte sulmuar të gjitha këto vende pa armët e SHBA-së, pa mbështetjen politike të SHBA-së, pa mbështetjen ushtarake të SHBA-së dhe pa mbështetjen e inteligjencës amerikane", shtoi Jarrar. "Izraeli nuk do të kishte aftësinë për ta shtyrë rajonin në atë që kemi tani, që është lufta rajonale."
Roli i SHBA-së në zgjidhjen e konfliktit në Gaza është kyç por a ekziston vullneti për paqe?
SHBA-ja, e cila ka mbështetur Izraelin, ka një rol të rëndësishëm në këtë situate për të sjellë stabilizimin dhe paqen. Ndihma dhe politika e SHBA-së do të ndikojnë ndjeshëm në drejtimin e situatës. Nëse SHBA-ja e mbështet më tej Izraelin në përballimin e kërcënimeve të reja, kjo thjesht do të kontribuojë në një eskalim të mëtejshëm të konfliktit.
Aktivizimi i Hezbollahut dhe Iranit, si dhe ndërhyrja ushtarake e SHBA-së, mund të krijojnë një përshkallëzim të konflikteve me pasoja të mëdha jo vetëm për Lindjen e Mesme por dhe për stabilitetin global.
Një qasje e ekuilibruar dhe e orientuar për ndërtimin e paqes është e domosdoshme për të evituar përshkallëzimin dhe për të kontribuar në një zgjidhje të qëndrueshme të konfliktit. Vetëm përmes angazhimit të sinqertë për paqe dhe stabilitet mund të arrihet pajtimi i madh në Lindjen e Mesme.

**Dear readers and followers of Argumentum.al**

On the third anniversary of the founding of the online media Argumentum.al, now it comes in the version of a monthly magazine which you can browse online from April 2022.

This monthly publication offers a clear combination of news on Albania, the Western Balkans and the world, as well as opinions and analyses of events taking place during the month.

Thanking each of you for your attention and trust in our media, we promise that we will continue to publish objective analysis on key developments in the country, region, Europe and the world.

Argumentum.al strives to be an authoritative source of journalism with analyses and comments on international relations, world politics and a wide range of issues of global importance by publishing exclusive materials. This is done thanks to the contribution of some of the well-known names of Albanian politics and journalism and other local and foreign collaborators. At the same time, Argumentum.al is open for comments and opinions by its readers.

Read on domestic and international issues in the magazine Argumentum.al free of charge in Albanian and English!

***"Argumentum", an intellectual process…***

# "English Edition"

# Minister Igli Hasani's Conversation with Journalists Following "Diplo 2024"




During a briefing with journalists following the conclusion of the Ambassadors' Conference, Minister for Europe and Foreign Affairs, Igli Hasani, emphasized that the Albanian government is redy for the second intergovernmental conference with the European Union. "We are ready, and we have been ready for a year. The first set of chapters is completed, and we're prepared for the next two groups. Our negotiating team is working to ensure that political obstacles do not disrupt the technical agenda. I'm optimistic that this fall will see significant developments, allowing us to progress rapidly towards the EU," he stated.

Minister Hasani highlighted the Ministry's increased focus on Albanians in the region, with the establishment of a new directorate dedicated exclusively to all Albanians in the region, as well as the mapping and composition of diplomatic representations around the world.

He also announced the opening of new embassies in India, Indonesia, and Kenya to strengthen Albania's diplomatic presence.

While discussing the upcoming summits scheduled to be held in Tirana, Minister Hasani remarked that Albania is in a moment that must be maximized.

"We are in the phase of internal preparations, identifying venues, funds, and personnel to make this possible. This shows that Albania is an important partner and an indispensable ally in the overall efforts of the North Atlantic organization in light of current events."

According to Minister Hasani, Albania's EU membership, the 2030 agenda, as well as the country's positive moment in tourism and economy, require maximum engagement from our representatives worldwide.

Presenting the new law on the foreign service, the Minister said that this law would energize diplomacy.

"We must leverage the best of our people, the best of Albanians wherever they are, and that is the purpose of this law. I'm confident it will offer a golden opportunity to a talented new generation of diplomats who will drive our country forward, with or without us in our current roles," emphasized Minister Hasani.

# The Council of Albanian Ambassadors supports the protest and the laegitimate demands of Albanians in the Presheva Valley




The Council of Albanian Ambassadors has followed with special attention the protest of August 12, 2024 of Albanians living in Serbia against Serbia's state discrimination, a legitimate protest and requests in defense of their civil rights and ethnic identity.

Subsequently, the Council of Albanian Ambassadors has denounced the absurd behavior of the Serbian state towards Albanians, especially the passivation of addresses and the denial of their national rights, which are also sanctioned in the Constitution of Serbia and which apply to every other minority.

The Council of Albanian Ambassadors considers discriminatory the lack of basic rights for a normal life refusing to respect the three agreements signed with the Albanian representatives.

We will not stop supporting our sisters and brothers of the Presheva Valley in their efforts to be treated as equal citizens. Their voice and that of their political representatives must be heard and respected!

The Council of Albanian Ambassadors calls on the authorities in Belgrade to respect all the obligations arising from the European Convention on the Rights of Minorities that Serbia has signed and to stop any form of discrimination against Albanians living in their centuries-old lands in the Presheva Valley.

# Officials of United States and the EU voice further support for lithium mining in Serbia

Geoffrey Pyatt, Assistant Secretary of State for Energy Resources at the U.S. Department of State, posted yesterday on X a supportive statement regarding the planned lithium mining project in Serbia. European Union Delegation to Serbia also posted on the same social network, supporting the recently established EU-Serbia partnership in critical raw materials.

In his post, Assistant Secretary of State Pyatt wrote that "Serbia's Jadar lithium project is an opportunity to contribute to the green transition at home and abroad".

"It would grow Serbia's economy and make it a leader in Europe's renewable energy sector. This can be done in a way that meets the highest environmental standards and protects Serbia's natural resources", Pyatt wrote.

EU Delegation to Serbia, meanwhile, released a post in Serbian, quoting the post of European Commissioner Maroš Šefčovič, who signed the Memorandum of Understanding with the Government of Serbia on 19 July in Belgrade.

In the post, the EU Delegation wrote that the goal of the EU-Serbia partnership is "to promote the development of new local industries and high-quality jobs along the electric vehicle value chains, with full respect to the high environmental and social standards and respect for the concerns of local communities with full transparency".

The posts were released days after a mass protest against lithium mining in Belgrade. It was a part of the wave of highly attended protests, organised by environmental associations, which took place in dozens of cities and towns across the country since the signing of the EU-Serbia Memorandum on 19 July.

President of Serbia Aleksandar Vučić announced that he would hold a series of meetings with the local population in Western Serbia, where the mine is planned to be opened, with the aim of listening to their concerns and reassuring them that the project would be safe. He will hold the first such meeting today.

# UNSETTLED TIMES



By Dr J Scott Younger

It is 22nd July, eight days after my grand-daughter's birthday. The 14th will be remembered not for the Spanish triumphs at the Euro '24 soccer tournament or the Tennis win of the new kid on the block, **Carlos Alcaraz**, at Wimbledon, but for the assassination attempt on the life of the Presidential hopeful, **Donald Trump**. The headlines were graphic, and point to a failure of the security detail.

This plus a rather strange decision, case dismissed, by the relatively untried prosecutor in the case against Donald Trump for mishandling a large number of highly confidential files from the time that he was in the White House, 2017-2021. It puts him in a strong position to win the Presidential election come November. Even other prosecutors are querying the decision which makes it seem that something is wrong with the US justice system, which would seem subject to political aims. Come what may, the decision by the prosecutor would leave Trump free to contest the election and, once elected, the system is such that he can pardon himself from the several other cases outstanding against him. "*No one is above the law*" – except the President! Really?

The last period has not been good for President **Joe Biden**, glaringly seen as stumbling when walking or speaking. He has been diagnosed with a mild form of covid, but there is no denying there is a groundswell of movement that is asking him to step aside. His powers are obviously waning, and it is doubtful if he could withstand another 4 years in the White House. The US domestic economy has been sound during the Biden years, he has embraced the forces of climate change, somewhat controversial in the US, but his foreign policy has been decidedly patchy. Afghanistan, the Ukraine war, and more recently the Israel-Palestine conflict. At last, a few days ago Biden realised the groundswell of Democratic opinion against his standing again, and resigned effective the end of his allotted term in January 2025. He immediately endorsed his Vice-President, **Kamala Harris**. The Democratic party quickly offered their support and the coffers were filled with $81 million for her campaign.

Trump has chosen **J D Vance**, Senator from Ohio, as his Vice-Presidential running mate. He represents the working- class Americans, once a strong opponent of Trump, now an ally. His credentials so far make him an America-first candidate which does not auger well for the complex world which faces the nations normally allying with the US. The next few months will tell.

The Democratic party have finally obtained a sound and honourable candidate, free from convictions for serious misdemeanours, and showing leadership qualities. Have they left adequate time for Harris to show her potential, and the electorate, particularly the undecided, to gather round the Democrats?

### From Harris to an Unsettled World

Meanwhile, the ongoing places of conflict, the Gaza strip and Ukraine, bubble along. PM **Benjamin Netanyahu**'s Israeli troops are carrying on as 'normal' in Gaza, now that the US is occupied with domestic affairs, bombing school targets ostensibly while seeking one Hamas leader and with no thought towards collateral deaths of innocent Palestinian women and children sheltering in a place designated as a refuge. The UN International Court of Justice have called out these heart-rending

crimes and the illegal Israeli land grab in the West Bank. But until much stronger measures are put in place, like drastically reducing the supply of arms to Israel, particularly by the US, imprisoning Netanyahu as promoter of these wrongdoings, then forcing Israel to contribute payment for some of the rebuilding of Gaza as part of the 2-state solution, an idea long in the planning, Gaza will continue to be bombed and innocent women and children killed. It is not known, at this stage, where the Republicans stand on the Gaza conflict – non-interference? Trump was a robust Israeli supporter in his previous stint, but the conditions are different now.

The Republicans or more accurately Trump has said he would seek an end to the war in Ukraine. He reckons he has a good rapport with **Vladimir Putin**. Irrespective of this, Putin is unlikely to give up much or any of the land he has gained, albeit illegally, nor is **Volodymyr Zelenskyy** likely to cede territory. Somehow one sees a trade off since the war cannot go on for ever, a price for ceding to Russia a portion of land – the land of East Ukraine is rich in wheat, and for Ukraine, war reparations, immediate membership of NATO, with US support guaranteed plus rearming Ukraine. In addition, a joint committee of high-level empathetic Ukrainians and Russians is formed to work together for the years to come with the remit to produce a peaceful and profitable border land, say called Ukrussaine! And become a model for a bigger potentially looming threat, climate change.

**George Friedman**'s (2009) book considered the world political development over this century – "*The next 100 years*". He thought that, looking forward, the US would dominate world affairs for most of the century, and only in the last quarter would other players become strong enough to exhibit a challenge. That forecast did not see a situation of the US appearing so divided already that people are worried that the scenario does not descend towards civil unrest, two seriously opposed factions. We Europeans and other nations are watching carefully the drama unfold, as does Putin the East and other members of the BRICS bloc. Where do we go after that?

# UKRAINIAN AMBASSADOR APPEALS FOR GERMAN SUPPORT IN BUDGET



The Ukrainian ambassador to Germany, Oleksii Makeiev, has urged the government not to waver in its support for Ukraine, according to a German newspaper report on Sunday.

Makeiev emphasized that the security of Europe depends on Germany's ability and political will to continue playing a leading role in supporting Ukraine, in Bild am Sonntag newspaper.

He expressed hope that the government would find ways to fund their joint security needs and that the parliament, or Bundestag, would speak strongly and clearly on the 2025 budget.

His comments come after another newspaper report stating the German government does not plan to release any additional money for military support to Ukraine for the time being.

The Frankfurter Allgemeine Sonntagszeitung (FAS) report cites a letter from Finance Minister Christian Lindner dated August 5.

The letter, also seen by dpa, suggests that future support for Ukraine might come from interest on frozen Russian state assets, as decided by the Group of Seven (G7) leading industrialized states.

On Saturday, a spokesman for the Ministry of Finance said the ministry was ready to consider the short-term provision of additional funds. He stated that the additional needs must be reported concretely and be comprehensible to comply with all budgetary regulations, and that the Bundestag would be asked for its approval on this basis. So far, no specific request for need has been submitted to the Ministry of Finance, meaning it cannot be examined or decided, he said, handing responsibility to the Defence Ministry.

ARGUMENTUM

news opinion analysis

**Adresa: Njësia bashkiake nr. 5, Rruga "Abdyl Frasheri", Ndërtesa 8, Tiranë, Shqipëri**

**Tel: +355 (0) 68 82 01 720**

**Email: redaksia.argumentum@gmail.com,**

**info@argumentum.al**

**NUIS/NIPT: L91415033Q**

**Twiter : Argumentum_al**

**Facebook: argumentum.al**

**Instagram: argumentumnews**

**© Argumentum. All rights reserved**